



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rr“Abdi Toptani”, nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____2018

V E N D I M

Nr. _____, Datë _____

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TEMATIK TË USHTRUAR NË 10
SUBJEKTE**

**“MBI VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË MASAVE TË REKOMANDUARA NË
AUDITIMET E MËPARSHME”.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Shoqërive Publike dhe Projekteve me Financimet e Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016, “*Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacioni që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH*”, nga ku rezultoi se realizimi i rekomandimeve në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

-Masa për përmirësime ligjore janë rekomanduar 2, nga të cilat janë pranuar 2 masa ose 100% e tyre. Masat e pranuar janë në proces zbatimi.

-Masa organizative janë rekomanduar 177, nga të cilat janë pranuar 168 masa ose 95% e tyre, të pa pranuar 9 masa ose 5% e tyre. Nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 26 rekomandime, zbatuar pjesërisht 7 rekomandime, në proces 134 rekomandime dhe nuk është zbatuar 1 rekomandim.

-Masa zhdëmtimi janë rekomanduar 77 për vlerën 2,960,975 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 70 masa në vlerën 2,576,903 mijë lekë ose 91.% e tyre, nuk janë pranuar 7 masa në vlerën 384,072 mijë lekë ose 9% e tyre. Nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 5 rekomandime në vlerën 2,064,947 mijë lekë, është zbatuar pjesërisht 1 në vlerën 41,579 mijë lekë, në proces zbatimi 64 rekomandime për vlerën 470,377 mijë lekë.

-Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, janë rekomanduar gjithsej **50 masa** për vlerën 11,241,071 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar **45 masa** në vlerën 11,234,347 mijë lekë ose 90 % e tyre, nuk janë pranuar 5 masa në vlerën 6,724 mijë lekë ose 10%. Nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 2 në vlerën 9,089,849 mijë lekë, pjesërisht **0** në vlerën 0 mijë lekë, në proces zbatimi **37** rekomandime për vlerën 2,084,128 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar 6 rekomandime, për vlerën 60,370 mijë lekë.

-Masa administrative janë rekomanduar gjithsej 2 masa, nga të cilat është pranuar 1 masë ose 50 % e tyre. Nga masat e pranuar, është zbatuar plotësisht 1.

-Masa disiplinore janë rekomanduar gjithsej 106, nga të cilat janë pranuar 101 masa ose 95 % e tyre dhe nuk janë pranuar 5 masa ose rreth 5% e tyre. Nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 77 rekomandime, zbatuar pjesërisht 22 rekomandime, është në proces 1 rekomandim dhe nuk është zbatuar 1 rekomandim.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të auditimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar në periudhën tetor 2017 deri prill 2018, të ushtruar në: Shoqërinë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” (KESH) Sh.a për dy auditime të evaduara respektivisht në dhjetor 2017 dhe prill 2018, Qendra Spitalore “Dr. Xhafer Kongoli” Elbasan, Ujësjiellës Kanalizime Shkodër Sh.a, Rezidenca e Studentëve nr. 2, Tiranë, Autoriteti i Aviacionit Civil, Porti Detar Sarandë, Porti Detar Vlorë, Hekurudha Shqiptare, Enti Kombëtar i Banesave.

II. TË RIKËRKOJ marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si më poshtë:

1. SHOQËRIA “KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE” (KESH) SH.A, EVADUAR NË MUJIN DHJETOR 2017.

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1223, prot., datë 31.10.2018, si dhe autorizimit nr. 1223/8, prot., datë 01.11.2018 me objekt: Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në Shoqërinë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” Sh.a. (KESH sh.a.) Tiranë.

Në auditimin e ushtruar në Shoqërinë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” (KESH) Sh.a, Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH me objekt mbi “Përputhshmërinë (pajtueshmërinë) dhe rregullshmërinë për periudhën e veprimtarisë 01.01.2016 deri me datë 31.03.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 212 dat 29.12.2017, t Kryetarit t KLSH-s të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 689/9 prot, datë 29.12.2017, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 277/3 prot., datë 24.01.2018 “Për njoftimin e planit të veprimeve për masat e marra nga KESH sh.a. për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Për secilën masë organizative, shpërblim dëmi dhe disiplinore janë nxjerr urdhrat respektiv nga Administratori, për zbatimin e detyrave të rekomanduara. Është hartuar plani i veprimit në zbatim të detyrave për ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, plan i cili është miratuar vendim nr. 1, datë 23.01.2018 nga Këshilli Mbikëqyrës.

Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a,

nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

A. Masa organizative: Janë rekomanduar 18 nga të cilat nga të cilat janë pranuar 14 masa ose 77.8 % e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 4, në proces zbatimi 10 dhe 4 masa nuk janë pranuar.

B.1. Masa shpërbllim dëmi: Janë rekomanduar 9 masa për vlerën 967,919 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 9 masa për vlerën 967,919 mijë leke, ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar janë në proces zbatimi 8 prej tyre për vlerën 107,919 mijë lekë dhe 1 masë në vlerën 860,000 mijë konsiderohet e zbatuar plotësisht pasi është ezauruar.

C.1. C2. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike janë rekomanduar 9 për vlerën 9,446,293 mijë lekë, të cilat janë pranuar. Nga këto, 8 masa për vlerën 360,223 janë në proces zbatimi, ndërsa 1 masë në vlerën 9,086,070 mijë lekë është zbatuar plotësisht.

D. Masa me karakter disiplinor: Janë rekomanduar 19 nga të cilat janë pranuar 16 masa ose 85 % e tyre. Nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 10, janë zbatuar pjesërisht 6 dhe nuk janë pranuar 3 masa disiplinore.

REKOMANDIMET

Në përfundim rikërkojmë nga Shoqëria “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” (KESH) Sh.a, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 689/9 prot, datë 29.12.2017, mbi auditimin me objekt mbi “Përputhshmërinë (pajtueshmërinë) dhe rregullshmërinë, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, edhe pse ka kaluar afati 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në lidhje me Auditin e Brendshëm, u konstatua se:

-Për z. G.Sh me detyrë drejtues i njësisë së auditit të brendshëm për periudhën deri më datë 19.04.2016, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk provohet plotësimi i 5 viteve të përvojës si auditues i brendshëm ose i jashtëm, në kundërshtim me Ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11, pika 2, germa b.

-z. N.K me detyrë drejtues i njësisë së auditit të brendshëm për periudhën 19.01.2017 e në vazhdim, ka filluar punë në shoqërinë KESH SHA, më datë 06.06.2016, në detyrën e Shefit të Sektorit të Financës. Më pas me shkresën e Administratorit nr. 328, datë 18.01.2017, emërohet Drejtor i Auditit të Brendshëm. Emërimi i z. N.K në pozicionin e drejtorit të auditit të brendshëm, është në kushtet e konfliktit të interesit, për arsye se ka qenë i punësuar në këtë shoqëri përpara marrjes së kësaj detyre, veprim ky në kundërshtim me Ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 18, pikën 1 dhe pikën 2, germa a.

-Specialisti i Auditit të Brendshëm z. S.L, ka filluar punë në shoqërinë KESH SHA më datë 05.07.2007, në detyra të ndryshme. Me shkresën e Administratorit nr. 332, datë 19.01.2017 “Për ndryshimin e pozicionit të punës”, emërohet Audit i Brendshëm. Emërimi i z. S.L në pozicionin e Specialistit të Auditit të Brendshëm, është në kushtet e konfliktit të interesit, për arsye se ka qenë i punësuar në këtë shoqëri përpara marrjes së kësaj detyre, veprim ky në kundërshtim me Ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 18, pikën 1 dhe pikën 2, germa a (*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 1, faqe 4*).

Rekomandimi 1: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të merren masa që rekrutimi i stafit të Njesisë së Auditit të Brendshëm të kryhet në zbatim të kërkesave të Ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, duke shmangur konfliktin e interesit, si dhe të merren masa për përshtatjen e Njesisë aktuale të Auditit të Brendshëm me kërkesat ligjore.

2. Gjetje nga auditimi:

Auditi i Brendshëm në KESH SHA me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 20.12.2016, ka kaluar në varësi të Administratorit të shoqërisë, në kundërshtim me Ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nenin 4, pika 18, e cila përcakton se: “18. *“Titullari i njësisë në shoqëritë tregtare” është organi përgjegjës për përcaktimin e politikave të shoqërisë, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, si dhe nenin 10, pika 2, e cila përcakton se: “*Njësia e auditimit të brendshëm është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike*”.

Varësia e Njesisë së Auditit të Brendshëm nga Administratori i shoqërisë, çënon parimin e pavarësisë dhe objektivitetit, si një nga parimet bazë të funksionimit të auditit të brendshëm, në kundërshtim me Ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, nenin 7, pika germa ç, e cila përcakton se: “*Auditimi i brendshëm në sektorin publik ushtrohet dhe mbështetet mbi parimin e: ç) pavarësisë dhe objektivitetit, i cili nënkupton pavarësi në ushtrimin e veprimtarisë audituese dhe dhënien e mendimeve e të gjykimeve objektive gjatë kryerjes së auditimeve;*”, reflektuar kjo dhe mos realizimin e planit vjetor të auditimeve nga kjo njësi (a *(Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 3, faqe 5)*).

Rekomandimi 2: Nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të merren masa për revokimin e Vendimit nr. 12, datë 20.12.2016, si një vendim i paligjshëm i cili ka ndikuar negativisht në efektivitetin e Njesisë së Auditit të Brendshëm.

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin nr. 14, datë 20.12.2016, ka miratuar dhënien e shpërblimit financiar (paga 13) për punonjësit e Shoqërisë “KESH” SHA, pa marrë më parë miratimin e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1 a *(Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 12, faqe 14)*.

Rekomandimi 3: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa që shpërblimet për punonjësit në fund të vitit, të jepen pas daljes dhe miratimit të rezultatit ekonomiko-financiar të shoqërisë nga Aksioneri i vetëm, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kontratës Kolektive të punës neni 62, kontratave individuale të punës, pika 7, i kërkojmë Administratorit të Shoqërisë, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

III. “Vërejtje” për:

2. **F.Z**, me detyrë teknik specialist për periudhën objekt auditimi, në cilësinë e anëtarit të komisionit të përlogaritjes së fondit limit.
3. **E.P**, me detyrë shefë e sektorit të monitorimit të digave për periudhën objekt auditimi, në cilësinë e anëtarit të komisionit të përlogaritjes së fondit limit.
5. **z.I.H**, me detyrë teknik specialist ekspert për periudhën objekt auditimi, në cilësinë e anëtarit të komisionit të përlogaritjes së fondit limit.

2. SHOQËRIA “PORTI DETAR” SH.A SARANDË

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1223, prot., datë 31.10.2018, si dhe autorizimit nr. 1223/4, prot., datë 01.11.2018 me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në “Portin Detar” Sh.a Sarandë.

Në auditimin e ushtruar në Shoqërinë “Porti Detar” sh.a Sarandë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH me objekt mbi “Përputhshmërinë (pajtueshmërinë) dhe rregullshmërinë për periudhën e veprimtarisë 01.06.2014 dhe 30.09.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 14 dat 28.02.2018, t Kryetarit t KLSH-s të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1044/8 prot., datë 02.03.2018, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Porti Detar” Sh.a Sarandë, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 205 prot., datë 26.03.2018 “Informacion për marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Për secilën masë organizative, shpërblim dëmi dhe masa disiplinore janë nxjerr urdhrat respektiv nga Drejtori, për zbatimin e detyrave të rekomanduara. Është hartuar programi i masave p r zbatimin e rekomandimeve t KLSH i firmosur nga Drejtori i Portit me nr.192 prot., dat 23.03.2018.

Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Porti Detar” sh.a Sarandë, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimi i rekomandimeve është si më poshtë:

A. Masa organizative: Janë rekomanduar 16 nga të cilat janë pranuar 16 masa ose 100 % e tyre. Të 16 masat e pranuar janë në proces zbatimi.

B.1. Masa shpërblim dëmi: Janë rekomanduar 7 për vlerën 2,707 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 7 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1 në vlerën 28 mijë lekë janë në proces zbatimi 6 prej tyre për vlerën 2,679mijë lekë.

B2. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara ne administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike: Janë rekomanduar 5 masa me vlerë 4,827 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 4 masa me vlerë 4,827 mijë lekë, nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1masë në vlerën 3,779 mijë lekë dhe janë në proces zbatimi 4 masa me vlerë 1,048 mijë lekë.

D. Masa me karakter administrativ: Është rekomanduar 1 dhe nuk është pranuar.

D.Masa me karakter disiplinor: Janë rekomanduar 10 nga të cilat nga të cilat janë pranuar dhe janë zbatuar pjesërisht 10.

REKOMANDIMET

Në përfundim rikërkojmë nga “Porti Detar” Sh.a Sarandë, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën shkresën nr. 1044/8 prot., datë 02.03.2018, mbi auditimin me objekt mbi “Përputhshmërinë (pajtueshmërinë) dhe rregullshmërinë, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm,

kanë rezultuar të pa zbatuara, edhe pse ka kaluar afati 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

A. MASA ADMINISTRATIVE

Rekomandimi: Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 5, 15 dhe 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Shoqëria “Porti Detar” SHA Sarandë, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Sarandë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë në masën 200,000 lekë, për shoqërinë konsulente “D.C”, **për arsye se:**

- Në tenderin “Hartimi i projektit për zgjerimin e kalatës së re të trageteve, në drejtim të jugut”, si dhe në dokumentacionin e projektit të zbatimit, kryesisht prerjeve tërthore mbi të cilat është bazuar thellësia e pilotave dhe materiali përkatës i cili do të gërmohet nëpërmjet sondave rezulton se afërsisht 20 % e thellësisë së pilotave do të vendosen në material shkëmbor ndërsa 80 % e thellësisë së tyre do të vendosen në shtresë zhavorri ose material tjetër jo shkëmbor, sipas të cilit çmimi për njësi duhet të ishte i ndryshëm. Në këto kushte, çmimi i aplikuar dhe ai që duhet të aplikohet për 80 % të gjatësisë së tyre.

Nga përlllogaritjet duke marrë në konsideratë sa më sipër, rezulton se, preventivit të hartuar i është shtuar padrejtësisht vlera 422,864,596 lekë.

U verifikuan sasi të përshkruara në preventiv si më poshtë:

Seksioni 1 “Nënstruktura”, pika 1.3.457 “Shpim me sonda “UKS” 1 m, - 20 m, tokë shkëmbore” sasia 10496 ml, i korrespondon sasia e betonit në shumën 8239 m³ beton.

Seksioni 1 “Nënstruktura”, pika 1.3.457/8 “Shpim me sonda “UKS” 1.5 m, - 20 m, tokë shkëmbore” sasia 2610 ml, i korrespondon sasia e betonit në shumën 1468 m³ beton.

Seksioni 1 “Nënstruktura”, pika 5 “Beton me çakëll C 35/45 për pilota rezistente ndaj ujit të detit” është përshkruar sasia 23139 m³, me diferencë 13432 m³ (23139 m³ – 8239 m³ – 1468 m³). Vlera e përfshirë më tepër në preventiv, për këtë zë punimi është 268,640,000 lekë (13432 m³ x 20,000 lekë/m³).

Vetëm sa më sipër, në rastin e një prokurimi të mundshëm për këtë investim, fondi limit do të ishte më i lartë se sa fakti me vlerë afërsisht 691,504,596 lekë (422,864,596 lekë + 268,640,000 lekë). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 19.10.1998 "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit" neni 5.

Preventivi është përcaktuar me vlerë 6,318,031,166 lekë. Bazuar në sa më sipër, vlera e preventivit duhet të jetë 5,626,526,570 lekë.

-Gjatë zbatimit të kontratës “Zgjerimi i terminalit të trageteve”, dokumentacioni për ndryshimin e konstruksionit të çatisë së ndërtesës ka mangësi në përlllogaritjen e peshës së profileve metalike, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 213,892 lekë a (*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet në faqen 48*).

3. QENDRA SPITALORE “DR. XHAFER KONGOLI” ELBASAN

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1223,prot., datë 31.10.2018, si dhe autorizimit nr. 1223/3, prot., datë 01.11.2018 me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtuar në Qendrën Spitalore “Dr. Xhafer Kongoli” Elbasan.

Nga auditimi i ushtruar në Qendrën Spitalore “Dr. Xhafer Kongoli” Elbasan, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH me objekt mbi “Përputhshmërinë (pajtueshmërinë) dhe rregullshmërinë për periudhën e veprimtarisë 31.12.2015 dhe 31.12.2016 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 180 datë 20.12.2017, t Kryetarit t KLSH-s të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 864/7 prot, datë 20.12.2017, u konstatua se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Qendra Spitalore “Dr. Xhafer Kongoli” Elbasan, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 114 prot., datë 12.01.2018 “Informacion për marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Për secilën masë organizative, janë nxjerr urdhrat respektiv nga Drejtori, për zbatimin e detyrave të rekomanduara.

Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Qendra Spitalore “Dr. Xhafer Kongoli” Elbasan, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Masa organizative: Janë rekomanduar 15 nga të cilat nga të cilat janë pranuar 15 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar, janë në proces zbatimi 14 dhe 1 është zbatuar plotësisht. Qendrës Spitalore “Dr. Xhafer Kongoli” Elbasan nuk do ti drejtohem për të inkurajuar përsheptimin e zbatimit të masave që janë në proces.

4. SHOQËRIA “KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE” (KESH) SH.A, EVADUAR NË MUAJIN PRILL 2018.

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1223, prot., datë 31.10.2018, si dhe autorizimit nr. 1223/8, prot., datë 01.11.2018 me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtuar në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. (KESH sh.a.) Tiranë ”.

Nga auditimi i ushtruar në Shoqërinë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sha, Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH me objekt mbi “Përputhshmërinë (pajtueshmërinë) dhe rregullshmërinë për periudhën e veprimtarisë 01.04.2017 deri me datë 31.12.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 25 datë 07.04.2018, t Kryetarit t KLSH-s të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1113/9 prot, datë 07.04.2018, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 5321/84 prot., datë 18.05.2018 “Informacion për marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Për secilën masë organizative, shpërblim dëmi janë nxjerr urdhrat respektiv nga Administratori, për zbatimin e detyrave të rekomanduara. Është hartuar plani i veprimit në zbatim të detyrave për ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, plan i cili është miratuar me vendimin nr. 9, datë 18.05.2018 nga Këshilli Mbikëqyrës.

Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit i vënë në dispozicion konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimi i rekomandimeve është si më poshtë:

A. Masa organizative: Janë rekomanduar 13 nga të cilat janë pranuar 12 masa ose 92,3 % e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 2, në proces zbatimi 10 dhe nuk është pranuar 1.

B. Masa shpërblim dëmi: Janë rekomanduar 7 për vlerën 1,684,857 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 4 masa në vlerën 1,260,774 mijë lekë ose 57 % e tyre. Nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1 për vlerën 1,204,546 mijë lekë, janë në proces zbatimi 3 për vlerën 56,228 mijë lekë. Nuk janë pranuar 3 në vlerën 424,083 mijë leke.

B2. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efciencë dhe efektivitet të fondeve publike: Janë rekomanduar 2 për vlerën 111,193 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 2 për vlerën 111,193 mijë lekë ose 100 % e tyre . Janë në proces zbatimi 2 për vlerën 111,193 mijë lekë.

C. Masa me karakter disiplinor: Rekomandimi është zbatuar. Konkretisht është konkluduar nga drejtimi i shoqërisë se dhënia e masave në zbatim të raportit të mëparshëm të auditimit, si dhe vendimeve të enteve të tjera (APP etj) që kanë penalizuar punonjës të shoqërisë, kanë shteruar edhe masat që mund të ndërmerreshin në kuadër të këtij raport auditimi.

REKOMANDIMET

Në përfundim rikërkojmë nga Shoqëria “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” (KESH) sh.a, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1113/9 prot, datë 07.04.2018, mbi auditimin me objekt mbi “Përputhshmërinë (pajtuashmërinë) dhe rregullshmërinë, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, edhe pse ka kaluar afati 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr. 10, datë 15.12.2017, ka miratuar dhënien e shpërblimit financiar për punonjësit e Shoqërisë KESH sh.a në vlerën totale prej **45,506,995 lekë**, para daljes së rezultatit financiar, veprim në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1/b dhe pika 2. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë firmosur vendimin: E.Gj, E.Ç, A.K, A.M dhe E.K, referuar Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 163, pika 3 a (*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 3.1, faqe 82*).

Rekomandimi 1:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa që shpërblimet për punonjësit në fund të vitit, të jepen sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, dhe vetëm pas daljes dhe miratimit të rezultatit ekonomiko-financiar të shoqërisë me fitim dhe të miratuar nga Aksioneri i vetëm, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës "Pastrim i zonës para rrjetave metalike tek vepra e marrjes në kuotë 222 mnnd dhe rrjetave të punës tek seksionet e tubacioneve të agregatit nr. 4 HEC Fierzë", në situacionin përfundimtar është rritur volumi i dherave të pastruar, ndërkohë që gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës theksohet se volumi i punimeve është kryer në përputhje me vijën e prerjeve siç tregohet në vizatime dhe thellësinë e dhënë në projekt. Po ashtu në raportet progresive, të hartuara gjatë zbatimit të kontratës është theksuar se: "*Të gjitha punimet janë matur për t'u hedhur në librin e masave*". Këto

procesverbale janë nënshkruar nga kontraktori dhe mbikëqyrësi i punimeve dhe kanë të bëjnë me të gjithë periudhën e gërmimit.

- Në pikën 2 të raportit teknik përcaktohet: "*Në përgjithësi, të dhënat e projektit përputheshin me atë gfarë u konstatua në terren*".

Bazuar në sa më sipër, fondi rezervë është kërkuar të shfrytëzohet edhe pse është deklaruar se volumet nuk kanë ndryshuar. Në dokumentacionin teknik të dosjes nuk rezulton asnjë dokumentacion që vërteton matjen e volumit të gërmimeve në vend depozitim, skica apo matje të tjera, madje kërkesa për shfrytëzimin e fondit rezervë është bërë me datë 10.11.2017, ndërkohë që bazuar në procesverbalin e përfundimit të kësaj faze (faza e tretë), pastrimi i dherave ka përfunduar me datë 07.11.2017.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me specifikimet teknike pika 1.3 "Dokumentet dhe vizatimet" ku përcaktohet:

"Të gjitha vizatimet dhe dokumentet e tjera teknike që shoqërojnë këtë projekt do të jenë bazë për vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së punës që do të bëhet për zbatimin e këtij projekti. Kontraktori do të shqyrtojë projektin që në fillim të punës dhe përpara lidhjes së kontratës me investitorin e objektit. Kontraktori do të verifikojë të gjitha sasisë, përmasat, të dhënat teknike dhe detajet e dhëna në vizatimet dhe dokumentet teknike që shoqërojnë këtë projekt. Kontraktori do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në kryerjen e llogaritjeve për sasinë dhe llojet e materialeve, volumeve të punës dhe pajisjeve të kërkuara për kryerjen e kësaj pune".

Në procesverbalin e datës 07.11.2017 "Përfundimi i fazës së tretë" mbajtur nga përfaqësuesit e kontraktorit O.P, A.Gj dhe G.P dhe Mbikëqyrësi i punimeve A.J theksohet: "*Pastrimi i zonës përpara rrjetave është kontrolluar ecuria me anë të matjeve periodike me aparaturën tip Sonar, në mënyrë që procesi i pastrimit të zbatohet sipas kërkesave të projektit*".

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se shtesa e volumeve është e pa argumentuar dhe e pa justifikuar, si dhe vlera 17,123,256 lekë është përfituar padrejtësisht nga kontraktorët "S. U Sh.p.k & D S" dhe përbën dëm ekonomik.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës pika 1.3.

-Në Specifikimet teknike pika 1.6 paragraf 11, përcaktohet: "*Në grafikun dhe zbërthimin e metodologjisë së punës duhet të përfshihen të paktën këto aktivitete:*

-Bazuar në dokumentet e tenderit, kontraktori ka paraqitur për kryerjen e punimeve mjet lundruar "M/N P."D". Në këtë mjet do të instalohej sistemi i pompave, grejferi dhe sistemi i kontrollit elektronik të punimeve. Në fakt nga ana e kontraktorit është sjellë vetëm një platformë mbajtëse, në të cilën është vendosur një ekskavator L 832 me grejfer. Në këtë platformë nuk është vendosur sistemi i pompimit për thithjen e materialeve të imëta. Nga ana e kontraktorit nuk është përcaktuar origjina e mjeteve të sjella në terren, po ashtu në dosjen teknike nuk ka dokumentacion mbi pronësinë e tyre, apo dokumentacionin ligjor për përdorimin e tyre.

-Në raportin teknik theksohet: "*Vinçi ekskavator është i pajisur me sistem pompimi për thithjen e llumrave me diametër më të vogël se 40 mm*". Nga verifikimi i përbërjes së këtij lloj mekanizmi si nëpërmjet fotove, ashtu edhe dokumentacionit tjetër në dosjen teknike rezulton se **nuk disponohet pompë për thithjen e llumrave** dhe si rezultat procesi i punës sipas zërit "*Heqja e materialeve inerte të imëta (llumra dhe gurë të vegjël < 40 mm*", ose volumi 320 m³ nuk është realizuar. Nga verifikimi në vend depozitimin e hedhjes së dherave nuk u konstatuan dhera me dimensione të imëta, megjithëse aty po punohet për realizimin e një kontrate tjetër.

Sa më sipër nga ana e kontraktorit është përfituar padrejtësisht vlera 22,944,000 lekë (320 m³ x 59,750 lekë/m³ + TVSH), vlerë e cila përbën dëm ekonomik. Po ashtu, nga ana e kontraktorit është përfituar padrejtësisht transport për këtë zë punimi me vlerë 1,512,000 lekë (280 m³ x 4,500 lekë/m³ + TVSH).

Për dy zërat e mësipërm (pastrim materiale të imëta dhe transporti përkatës), nga ana e kontraktorit (bashkimit të OE) "S. Sh.p.k & D.SRL", është përfituar padrejtësisht vlera 24,456,000 lekë (22,944,000 lekë + 1,512,000 lekë), vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë.

Në total, për këtë kontratë, nga ana e kontraktorit "S.Sh.p.k & D.SRL", është **përfituar padrejtësisht vlera 41,579,256** (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 3, faqe 94-96).

Rekomandimi 1:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 41,579,256 lekë**, nga kontraktori "S.Sh.p.k & D. SRL", për punime të likuiduara, por të pa realizuara gjatë zbatimit të kontratës "Pastrim i zonës para rrjetave metalike tek vepra e marrjes në kuotë 222 mmnd dhe rrjetave të punës tek seksionet e tubacioneve të agregatit nr. 4 HEC Fierzë", vlerë e cila për Shoqërinë "Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare" dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës së punimeve civile "Riparim i veshjes së betonit të digës në bjeftin e sipërm (kuota 280-296 mmnd)", janë çertifikuar punime të realizuara që kanë të bëjnë kryesisht me shkatërrimin e veshjes ekzistuese të amortizuar dhe vendosje skelerie në sasi dhe vlerë si më poshtë:

Përshkrimi i punimeve	Njësia	Çmimi	Sasia në situacion	Sasia faktike	Diferenca
		lekë	përfundimtar		lekë
		1	2	3	1 x (2 - 3)
Prishje strukture betoni	M ³	3,271	908.1	0	2,970,395
Transport me auto 5.0 km	"	372	908	0	337,813
Skelë shërbimi druri	"	1,523	426	0	648,798
Shuma:					3,957,006

Sa më sipër, vlera 4,748,407 lekë (3,957,006 lekë + TVSH) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "N" Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 7 a (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 4, faqe 98).

Rekomandimi 2: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 4,748,407 lekë, nga Shoqëria "N" Sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara gjatë zbatimit të kontratës "Veshje e bjeftit të sipërm të HEC Fierzë", vlerë e cila për Shoqërinë "Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare" dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

B.2. DËM EKONOMIK PA MUNDËSI ARKËTIM

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të blerjes së energjisë elektrike për periudhën Prill-Dhjetor 2017, dhe krahasimi me shitjen e po të njëjtës sasi energjie në të njëjtën periudhë sipas muajve respektiv nga kompania "KESH" SHA tek operatorët privat të tregut të energjisë, vihet re një diferencë e madhe midis çmimit të shitjes së energjisë nga "KESH" SHA dhe çmimit të blerjes së energjisë nga "OSHEE" SHA, me një diferencë në vlerën 2,831,747 euro, e ardhur si rezultat i diferencës së madhe midis çmimit të shitjes së energjisë nga Shoqëria "KESH" SHA kompanive E, G T, A B, dhe G etj dhe çmimit të blerjes së energjisë nga Shoqëria "OSHEE" SHA nga këto kompani. Shkaku;

a- më 31.01.2018, datë në të cilën ka përfunduar auditimi, nuk janë miratuar plotësisht (të gjitha) aktet nënligjore e rregullatore në zbatim të Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Miratimi dhe zbatimi sa më i shpejtë i gjitha akteve ligjore, nënligjore e rregullatore në zbatim të Ligjit 43/2015, do të bënte të mundur operimin e “KESH” SHA, në kushtet e një tregu konkurrues, duke mënjanuar kostot e panevojshme dhe duke rritur performancën financiare të shoqërisë, jo vetëm për periudhën aktuale por edhe në vështrimin perspektiv në sektorin e energjisë elektrike (kemi parasysh këtu periudhën kur do të fillojë funksionimin Bursa Shqiptare e energjisë elektrike).

b- ERE me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka krijuar problematikë serioze në zbatim të Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe VKM nr. 244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik”, i ndryshuar, duke dëmtuar në këtë mënyrë interesat e ligjshme të shoqërisë “KESH” SHA, si dhe të Shtetit, pasi me vendimet e saj të deritanishme “Për miratimin e rregullave të tregut”, paraqet paqartësi dhe madje konflikt të vetë dispozitave të rregullave të tregut, të cilat nuk janë hartuar në frymën e Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nuk janë përshtatur me periudhën tranzitore, e cila do të sillte kalimin normal në rregullat përfundimtare miratuar sipas modelit të tregut, duke u shfaqur si rregulla në zbatim të parashikimeve të Ligjit të vjetër. Konkretisht: Vendimi i ERE nr. 111 datë 01.07.2016 “Mbi lënien në fuqi të Vendimeve nr. 139, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, Vendimi i ERE nr.136, datë 15.08.2016 “Për miratimin e kontratës TIP për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga Shteti/KESH SHA dhe furnizuesit e shërbimit universal OSHEE SHA për periudhën 01.07.2016-31.12.2016”.

Edhe pse, përveç detyrimit ligjor në rolin e monitoruesit të shoqërive publike të tregut të energjisë, ERE ka përfituar nga Shoqëria “KESH” për periudhën 2014-2016, vlerën 101,406, 642 lekë, në zbatim të tarifave rregullatorë të vendosura çdo vit nga vetë ajo.

Deri në 31.01.2018, datë në të cilën përfundoj auditimi, nuk është hartuar dhe miratuar Rregullorja e re e procedurave të tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të VKM nr. 729, datë 08.12.2017 a (*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. B.2.1, faqe 103-104*).

Rekomandimi 1: Nga Administratori i Shoqërisë të prezantohet në organet drejtuese **vlera 2,831,747 euro**, që përfaqëson diferencën midis çmimit të shitjes së energjisë në vlerat 11.11 deri në 61.14 euro nga “KESH” SHA tek operatorët privatë të tregut të energjisë (EA, G T, A B, dhe G etj) dhe çmimit të blerjes së energjisë në vlerën 56.6 deri në 95.5 euro nga “OSHEE” SHA, pra këta operator energjinë e kanë blerë nga shtetit shqiptar (Shoqëria “KESH” SHA dhe përsëri ja kanë shitur shtetit (Shoqërisë “OSHEE”) me çmim shumë herë më të lartë duke i krijuar një humbje të drejtpërdrejtë buxhetit të shtetit dhe në fund të fundit një detyrim financiar që e paguan konsumatori fundor shqiptar, vlerë e cila përbën dëmi ekonomik pa mundësi arkëtimi për Shoqërinë KESH SHA dhe për Buxhetin e Shtetit.

-Nga organet drejtuese të merren të gjitha masat për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores së re të procedurave të tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të VKM nr. 729, datë 08.12.2017, duke marrë në konsideratë problematikat që kanë dalë gjatë zbatimit të rregulloreve të mëparshme.

Shënim: Pavarësisht faktit që në auditimet e mëparshme të KLSH-së, kjo gjetje është klasifikuar si e ardhur e munguar, nga ana jonë kjo gjetje do të riklasifikohet për të gjitha rastet e konstatuara si masë shpërblim dëmi ekonomik pa mundësi arkëtimi.

5. AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL.

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1223 prot., datë 31.10.2018, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtuar në “Autoritetin e Aviacionit Civil” Tiranë.

Nga auditimi i ushtruar në Shoqërinë “Autoritetin e Aviacionit Civil” Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 38, datë 30.04.2018 t Kryetarit t KLSH-s të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1312/24 prot, datë 02.05.2018, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Autoriteti i Aviacionit Civil”, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresë nr. 794/3 prot., 27.06.2018 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit”.

Për sa më sipër është hartuar plani i veprimit për detyrat e lëna nga KLSH i miratuar nga Drejtori i institucionit me afate dhe personat e drejtoritë përgjegjëse për ndjekjen e tyre. *Për secilën masë organizative, të ç’dëmtimit dhe disiplinore janë nxjerrë urdhrat përkatës nga drejtori i institucionit, për zbatimin e detyrave të rekomanduara.*

Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Autoriteti i Aviacionit Civil”, ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 1754 prot datë 26.09.2018, duke zbatuar afatin 6-mujor për raportimin mbi ecurinë e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

A. Ndryshime dhe përmirësime legjislativi: Janë rekomanduar 2 masa, të cilat janë pranuar dhe janë në proces zbatimi.

B. Masa organizative: Janë rekomanduar 11 masa organizative gjithsej të cilat janë pranuar të gjitha ose 100% e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 4, është realizuar pjesërisht 1, janë në proces zbatimi 6.

C. Masa shpërblim dëmi: Janë rekomanduar gjithsej 21 masa për shpërblim dëmi ekonomik të arkëtueshëm në vlerën 259,118 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 17 ose 81 % e tyre në vlerën 258,630 mijë lekë dhe nuk janë pranuar 4 masa në vlerën 488 mijë lekë, ose 19 % e tyre. Masat e pranuar (11) nuk janë realizuar.

D. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike nga 7 rekomandime gjithsej në vlerën 30,281 mijë lekë, janë pranuar 6 dhe nuk është pranuar 1 masë në vlerën 880 mijë lekë. Nga rekomandimet e pranuar nuk është realizuar asnjë.

C. Masa me karakter disiplinor. Nga 5 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej (një masë është revokuar) janë pranuar të gjitha nga të cilat janë zbatuar plotësisht 4, ndërsa 1 është në proces (po ndiqen hapat e ankimit).

REKOMANDIMET

Në përfundim rikërkojmë nga Autoriteti i Aviacionit Civil, zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresë nr. 1312/24 prot, datë 02.05.2018, mbi auditimin me objekt mbi “Përputhshmërinë (pajtueshmërinë) dhe rregullshmërinë”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, edhe pse ka kaluar afati 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH mbi statutin e rekomandimeve të lëna.

C.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të godinës së AAC-së, për periudhën nga 01.01.2017 – deri në momentin e përfundimit të procedurave me mjete elektronike të prokurimit”, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën 1,075,272 lekë**, si rezultat i **procedurës së parregullt dhe fiktive të ndjekur nga AK**, konkretisht:

-AK nuk ka mbajtur dokumentacion lidhur me argumentimin dhe dokumentimin e vlerës së fondit limit, në kundërshtim me nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Mungon urdhri i titullarit të AK, për ngritjen e grupit të punës, për përllogaritjen e vlerës së fondit limit, në kundërshtim me nenin 56 të VKM së mësipërme.

-Titullari i AK, nuk ka nxjerrë urdhrin e prokurimit të procedurës së prokurimit, i cili duhet të përmbajë të gjithë elementët bazë, ashtu sikurse parashikohet në legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht neni 60, i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-AK ka zhvilluar një procedurë prokurimi me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës në kundërshtim me nenet 33, 38 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 36 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-AK nuk ka mbajtur dokumentacion tenderi (set dokumentesh), në kundërshtim me nenin 36 të VKM së mësipërme.

-AK nuk ka dokumentuar që operatori ekonomik plotëson minimalisht kërkesat e nenit 45 të LPP, në kundërshtim me nenin 36 të VKM së mësipërme.

-KVO ka hartuar dhe ka miratuar kërkesat për kualifikim, në kundërshtim me nenin 58 të VKM së sipërcituar.

-AK nuk provon me dokumentacion lidhur me njoftimet e shoqërive për marrjen dijani të ftesave për ofertë, në kundërshtim me nenin 13 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe këto ftesa për ofertë nuk përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm, *në mënyrë që t’u mundësojë kandidatëve të përzgjedhur të dorëzojnë ofertat e tyre.*

-Mungon argumentimi dhe dokumentimi i hartimit të kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM së sipërcituar.

-Mungon urdhri i veçantë i titullarit të AK, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me nenin 58, të VKM së mësipërme.

-Mungon procesverbali mbi argumentimin dhe dokumentimin e çmimit të shitjes së dokumenteve të tenderit, në kundërshtim me seksioni 5, pika 5.1 të DST.

-Data e hapjes së ofertave është 26.01.2017, ndërkohë që noterizimi i dokumentacionit të paraqitur në tender nga OE fitues mban datën 27.01.2017, e cila sjell si pasojë një vlerësim subjektiv dhe “fiktiv”, për sa është mbajtur dhe vlerësuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe negociimit, datën e hapjes dhe zhvillimit të procedurës, në kundërshtim me nenin 53/3, 55/2 të LPP.

-Në dosjen e prokurimit, mungon miratimi i raportit përmbledhës nga titullari i AK, në kundërshtim me nenin 68 të VKM. AK nuk ka zhvilluar negociim me operatorin ekonomik të paraqitur në tender, në kundërshtim me nenin 66/7 të VKM.

-AK ka vepruar në kundërshtim me pikën 1 të nenit 73, kreu VII të VKM së mësipërme, pasi nuk ka anuluar procedurën e prokurimit, në kushtet kur datën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave, nuk ka patur në dispozicion dokumentacionin e shoqërisë.

-KVO nuk ka plotësuar formularët e konfliktit të interesit, në kundërshtim me nenet 11/2, 16, 56, 64 të VKM (*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indetifikohet me nr. 5, faqe 125-126*).

Rekomandimi 1:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **1,075,272 lekë**, përkatësisht nga Znj. L. R në cilësinë e titullarit të AK, si dhe, Z. A.K, Z. Ç.J dhe Z. E.K, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe negocimit.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të godinës së AAC-së, për periudhën 01.01.2018 – 13.02.2018”, sipas UP Nr. 1800 Prot., datë 29.12.2017, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën 418,614.30 lekë**, si rezultat i procedurës në kundërshtim me LPP të ndjekur nga AK, konkretisht:

AK nuk ka mbajtur dokumentacion lidhur me argumentimin dhe dokumentimin e vlerës së fondit limit, në kundërshtim me nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Mungon urdhri i titullarit të AK, për ngritjen e grupit të punës, për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, në kundërshtim me nenin 56 të VKM së mësipërme.

Titullari i AK, nuk ka nxjerrë urdhrin e prokurimit të procedurës së prokurimit, i cili duhet të përmbajë të gjithë elementët bazë, ashtu sikurse parashikohet në legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht neni 60, i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në këtë urdhër mungojnë emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, lloji i procedurës dhe arsyt e përdorimit të saj.

AK ka zhvilluar një procedurë prokurimi me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës në kundërshtim me nenet 33, 38 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 36 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Mungon dokumentimi i publikimit të kontratës së nënshkruar, në kundërshtim me nenin 6/2 të VKM së mësipërme. Mungesa e këtij dokumenti, sjell si pasojë edhe mosdhënien e informacionit publik, mbi procedurën e zhvilluar nga AK.

AK nuk ka mbajtur dokumentacion tenderi (set dokumentesh), në kundërshtim me nenin 36 të VKM së mësipërme.

AK nuk ka dokumentuar që operatori ekonomik plotëson minimalisht kërkesat e nenit 45 të LPP, në kundërshtim me nenin 36 të VKM së mësipërme.

AK nuk provon me dokumentacion lidhur me njoftimet e shoqërive për marrjen dijeni të ftesave për ofertë, në kundërshtim me nenin 13 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe këto ftesa për ofertë nuk përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm, *në mënyrë që t’u mundësojë kandidatëve të për zgjedhur të dorëzojnë ofertat e tyre.*

Mungon argumentimi dhe dokumentimi i hartimit të kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM së sipërcituar.

Mungon urdhri i veçantë i titullarit të AK, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me nenin 58, të VKM së mësipërme.

Mungon procesverbali mbi argumentimin dhe dokumentimin e çmimit të shitjes së dokumenteve të tenderit, në kundërshtim me seksioni 5, pika 5.1 të DST. Në dosjen e prokurimit, mungon miratimi i raportit përmbledhës nga titullari i AK, në kundërshtim me nenin 68 të VKM.

AK nuk ka zhvilluar negociim me operatorin ekonomik të paraqitur në tender, në kundërshtim me nenin 66/7 të VKM.

AK ka vepruar në kundërshtim me pikën 1 të nenit 73, kreu VII të VKM së mësipërme, pasi nuk ka anuluar procedurën e prokurimit.

Mungojnë formularët e konfliktit të interesit, në kundërshtim me nenet 11/2, 16, 56, 64 të VKM (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 6, faqe 126-127).

Rekomandimi 2:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës prej 418,614.30 lekë, përkatësisht nga Z. K.K në cilësinë e titullarit të AK, si dhe Z. K.S në cilësinë e hartuesit të urdhrimit të prokurimit dhe Z.F.G në cilësinë e personit që ka miratuar hartimin e urdhrimit të prokurimit.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të Aeroportit të Kukësit, për periudhën 01.01.2018 – 26.02.2018”, sipas U.P. Nr. 1799 Prot., datë 29.12.2017, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën 2,677,967.24 lekë**, si rezultat i procedurës në kundërshtim me LPP të ndjekur nga AK, konkretisht:

AK nuk ka mbajtur dokumentacion lidhur me argumentimin dhe dokumentimin e vlerës së fondit limit, në kundërshtim me nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Mungon urdhri i titullarit të AK, për ngritjen e grupit të punës, për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, në kundërshtim me nenin 56 të VKM së mësipërme.

Titullari i AK, nuk ka nxjerrë urdhrin e prokurimit të procedurës së prokurimit, i cili duhet të përmbajë të gjithë elementët bazë, ashtu sikurse parashikohet në legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht neni 60, i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në këtë urdhër mungojnë emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, lloji i procedurës dhe arsytet e përdorimit të saj.

AK ka zhvilluar një procedurë prokurimi me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës në kundërshtim me nenet 33, 38 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 36 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Mungon dokumentimi i publikimit të kontratës së nënshkruar, në kundërshtim me nenin 6/2 të VKM së mësipërme. Mungesa e këtij dokumenti, sjell si pasojë edhe mosdhënien e informacionit publik, mbi procedurën e zhvilluar nga AK.

AK nuk ka mbajtur dokumentacion tenderi (set dokumentesh), në kundërshtim me nenin 36 të VKM së mësipërme.

AK nuk ka dokumentuar që operatori ekonomik plotëson minimalisht kërkesat e nenit 45 të LPP, në kundërshtim me nenin 36 të VKM së mësipërme.

AK nuk provon me dokumentacion lidhur me njoftimet e shoqërive për marrjen dijeni të ftesave për ofertë, në kundërshtim me nenin 13 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe këto ftesa për ofertë nuk përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm, *në mënyrë që t’u mundësojë kandidatëve të për zgjedhur të dorëzojnë ofertat e tyre.*

Mungon argumentimi dhe dokumentimi i hartimit të kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM së sipërcituar.

Mungon urdhri i veçantë i titullarit të AK, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me nenin 58, të VKM së mësipërme.

Mungon procesverbali mbi argumentimin dhe dokumentimin e çmimit të shitjes së dokumenteve të tenderit, në kundërshtim me seksioni 5, pika 5.1 të DST. Në dosjen e prokurimit, mungon miratimi i raportit përmbledhës nga titullari i AK, në kundërshtim me nenin 68 të VKM.

-AK nuk ka zhvilluar negociim me operatorin ekonomik të paraqitur në tender, në kundërshtim me nenin 66/7 të VKM.

-AK ka vepruar në kundërshtim me pikën 1 të nenit 73, kreu VII të VKM së mësipërme, pasi nuk ka anuluar procedurën e prokurimit.

-Mungojnë formularët e konfliktit të interesit, në kundërshtim me nenet 11/2, 16, 56, 64 të VKM.

-Në kontratën Nr. 1799 Prot., datë 29.12.2017, neni 2, pika 2.1, kohëzgjatja e kontratës, me vullnetin e tyre të lirë, palët kanë rënë dakord që kjo kontratë *i shtrin efektet e saj nga data 01.01.2017, me përfundim në 26.02.2017, ndërkohë që kjo periudhë kohore është paguar më parë nga AK (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 7 faqe 128-129).*

Rekomandimi 3:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 2,677,967.24 lekë, përkatësisht nga Z. K.K në cilësinë e titullarit të AK, si dhe Z. K.S në cilësinë e hartuesit të urdhrin të prokurimit dhe Z. F.G në cilësinë e personit që ka miratuar urdhrin e prokurimit.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje karburanti për nevojat e AAC-së”, sipas kontratës së nënshkruar Nr. 151/5 Prot., datë 19.04.2017, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën 1,332,940.5 lekë**, si rezultat i **procedurës fiktive të ndjekur nga AK**, konkretisht:

Kontrata për objektin e mësipërm të prokurimit është nënshkruar në datë **19.04.2017**, si dhe komisioni i marrjes në dorëzim është ngritur nga titullari i AK në datë **20.04.2017**. Ndërkohë, më datë **14.04.2017** komisioni i marrjes në dorëzim të mallit ka mbajtur një procesverbal jo të saktë dhe fiktiv, duke përcaktuar se ka marrë në dorëzim një produkt, për të cilin akoma nuk ishte lidhur kontrata midis palëve, si dhe për më tepër, kur akoma nuk kishte dalë urdhri se kush do të ishte komisioni i marrjes në dorëzim.

Operatori Ekonomik fitues ka prerë një faturë tatimore shitje Nr. 32, datë 06.04.2017, ndërkohë që akoma nuk kishte nënshkruar kontratën me autoritetin kontraktor.

Më datë 14.04.2017 është bërë hyrje në magazinën e institucionit sasia për lëngun gazoil dhe benzinë, në vlerë totale prej 1,332,940.5 lekë, ndërkohë që akoma nuk ishte nënshkruar kontrata midis palëve (nënshkruar datë 19.04.2017).

AK ka bërë një pagesë (me efekte prapavepruese), për një produkt, për të cilin akoma nuk ishte nënshkruar kontrata midis palëve.

AK, ka nënshkruar një kontratë “fiktive” me Nr. 151/5 Prot., datë 19.04.2017, ku në nenin 9 të saj ka përcaktuar që zbatimi i kontratës duhet të fillojë menjëherë me lidhjen e saj, ndërkohë që në datë 06.04.2017 malli është dorëzuar nga shoqëria, duke prerë edhe faturën tatimore përkatëse, produkt ky i cili është bërë hyrje në magazinë në datë 14.04.2016.

AK ka vepruar në kundërshtim me nenet 59 dhe 60 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

- OE i shpallur fitues, nuk plotëson specifikimet teknike, në kundërshtim me dokumentet e tenderit, si dhe nenin 23 të LPP (*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 8, faqe 129-130).*

Rekomandimi 4:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 1,332,940.5 lekë, përkatësisht nga Znj. L.R në cilësinë e titullarit të AK, Z. F.G në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike, i cili ka miratuar edhe pagesat përkatëse, Z. K.S në cilësinë e personit i cili ka nënshkruar në faturën e hyrjes së mallit, Znj.K.K dhe Znj.S. K në cilësinë e personave përgjegjës të cilët

kanë bërë edhe pagesat për sa është konstatuar, si dhe Znj. E.D, Znj. M.H ,znj. A.G në cilësinë e anëtarëve të grupit të marrjes në dorëzim të mallit.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të Aeroportit të Kukësit, për periudhën 01.01.2017 – 19.02.2017”, sipas U.P. Nr. 1892 Prot., datë 30.12.2016, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën 2,543,330 lekë**, si rezultat i **procedurës fiktive të ndjekur nga AK**, konkretisht:

-AK nuk ka mbajtur dokumentacion lidhur me argumentimin dhe dokumentimin e vlerës së fondit limit, në kundërshtim me nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Mungon urdhri i titullarit të AK, për ngritjen e grupit të punës, për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, në kundërshtim me nenin 56 të VKM së mësipërme.

-Titullari i AK, nuk ka nxjerrë urdhrin e prokurimit të procedurës së prokurimit, i cili duhet të përmbajë të gjithë elementët bazë, ashtu sikurse parashikohet në legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht neni 60, i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-AK ka zhvilluar një procedurë prokurimi me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës në kundërshtim me nenet 33, 38 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 36 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Mungon dokumentimi i publikimit të kontratës së nënshkruar, në kundërshtim me nenin 6/2 të VKM së mësipërme. Mungesa e këtij dokumenti, sjell si pasojë edhe mosdhënien e informacionit publik, mbi procedurën e zhvilluar nga AK.

-AK ka lidhur kontratën në datë 30.12.2016, ndërkohë që formulari i sigurimit të kontratës mban datën 06.01.2016, në kundërshtim me nenin 58/5 të LPP, si dhe nenet 11/1/2, 21/1/2, 24 të VKM.

-AK nuk ka mbajtur dokumentacion tenderi (set dokumentesh), në kundërshtim me nenin 36 të VKM së mësipërme.

-AK nuk ka dokumentuar që operatori ekonomik plotëson minimalisht kërkesat e nenit 45 të LPP, në kundërshtim me nenin 36 të VKM së mësipërme.

-AK nuk provon me dokumentacion lidhur me njoftimet e shoqërive për marrjen dijeni të ftesave për ofertë, në kundërshtim me nenin 13 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe këto ftesa për ofertë nuk përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm, *në mënyrë që t’u mundësojë kandidatëve të për zgjedhur të dorëzojnë ofertat e tyre.*

-Mungon argumentimi dhe dokumentimi i hartimit të kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM së sipërcituar.

-Mungon urdhri i veçantë i titullarit të AK, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me nenin 58, të VKM së mësipërme.

-Mungon procesverbali mbi argumentimin dhe dokumentimin e çmimit të shitjes së dokumenteve të tenderit, në kundërshtim me seksioni 5, pika 5.1 të DST.

-Data e hapjes së ofertave dhe kontrata është nënshkruar datë 30.12.2016, ndërkohë që dokumentacioni i paraqitur në tender nga OE fitues mban datën 05.01.2017, e cila sjell si pasojë një vlerësim subjektiv dhe “fiktiv”, për sa është mbajtur dhe vlerësuar nga AK, datën e hapjes dhe zhvillimit të procedurës, në kundërshtim me nenin 53/3, 55/2 të LPP.

-Në dosjen e prokurimit, mungon miratimi i raportit përmbledhës nga titullari i AK, në kundërshtim me nenin 68 të VKM.

-AK nuk ka zhvilluar negociim me operatorin ekonomik të paraqitur në tender, në kundërshtim me nenin 66/7 të VKM.

-AK ka vepruar në kundërshtim me pikën 1 të nenit 73, kreu VII të VKM së mësipërme, pasi

nuk ka anuluar procedurën e prokurimit, në kushtet kur datën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave, nuk ka patur në dispozicion dokumentacionin e shoqërisë. KVO nuk ka plotësuar formularët e konfliktit të interesit, në kundërshtim me nenet 11/2, 16, 56, 64 të VKM.

-Në kontratën Nr. 1892/1 Prot., datë 30.01.2016, neni 2, pika 2.1, kohëzgjatja e kontratës, me vullnetin e tyre të lirë, palët kanë rënë dakord që kjo kontratë i shtrin efektet e saj nga data 01.01.2016, me përfundim në 19.02.2016, ndërkohë që kjo periudhë kohore është paguar më parë nga AK (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 9, faqe130-131).

Rekomandimi 5:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 2,543,330 lekë, përkatësisht nga Z. F. Ç në cilësinë e titullarit të AK, Z. K.S në cilësinë e hartuesit të urdhrit të prokurimit, Z. A. K në cilësinë e personit që ka miratuar hartimin e urdhrit të prokurimit, Z. F.G në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike, i cili ka miratuar edhe pagesat përkatëse për sa është konstatuar më sipër, si dhe nuk ka vepruar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, referuar kjo kushteve të përcaktuara në kontratë, Znj.S.K dhe znj. K. K në cilësinë e personave përgjegjës të cilët kanë bërë edhe pagesat për sa është konstatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt: “Eventi në lidhje me Fushatën Publicitare për sensibilizimin e opinionit publik në lidhje me të drejtat e pasagjerëve dhe detyrimet e tyre (**blerje aplikacioni**)”, sipas kontratës së nënshkruar Nr. 1652/15 Prot., datë 15.12.2016, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën 2,020,000 lekë**, si rezultat i **procedurës fiktive të ndjekur nga AK**. Kjo për arsye se:

-Nuk është argumentuar nevoja e kryerjes dhe përfitimet e mundshme të këtij shpenzimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 4 “Fusha e zbatimit” dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26.

-Ky aplikacion nuk është planifikuar në programin ekonomik të vitit 2016, por është bërë ndryshim në fund të vitit me qëllim përdorimin e të ardhurave të papërdorura, ndryshim ky i pa argumentuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Aviacionin Civil”, i ndryshuar, neni 18, pika 3.

-Fondi limit nuk është i argumentuar dhe i dokumentuar.

-Anëtarët e grupit të punës nuk kanë kualifikimet dhe eksperiencën, në zhvillimin e kësaj procedure.

-Vlerësimi i ofertave të OE është kryer në mënyrë fiktive. Kontrata për objektin e mësipërm të prokurimit është nënshkruar në datë **15.12.2016**, për procedurën e zhvilluar në datë **14.12.2016**, ndërkohë që dokumentacioni i shoqërisë së shpallur fituese mban datën **19.12.2016** (vlerësim fiktiv, pa patur në dispozicion dokumentacionin).

-AK ka zhvilluar një procedurë, duke u shmangur nga përdorimi i Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar.

-AK, ka nënshkruar një kontratë Nr. 1652/15 Prot., datë 15.12.2016, me vlerë totale 2,020,000 lekë, ku në nenin 3.1 të saj parashikohet se: “Zbatimi i kontratës duhet të fillojë me nënshkrimin e saj, me kohëzgjatje për dorëzimin e punimeve deri në datë **15.01.2016**”, ndërkohë që aplikacioni është marrë në dorëzim më datë **05.01.2017**.

-Formulari i sigurimit të kontratës mban datën **16.12.2016**, ndërkohë që kontrata është nënshkruar në datë **15.12.2016**, në kundërshtim me nenin 58/5 të LPP, si dhe nenet 11/1/2, 21/1/2, 24 të VKM.

-AK nuk ka përcaktuar asnjë model mbi elementët për ofertën që kërkohet, mosveprim ky i cili shkakton konfuzion mbi ofertat që do të paraqiteshin për këtë procedurë, duke mos i vënë shoqëritë e ftuara në kushte të barabarta konkurrimi dhe vlerësimi.

-Në kundërshtim me nenin 68 të VKM, titullari i autorizuar i AK me shkresën Nr. 1652/12, datë 14.12.2016, ka bërë miratimin e raportit përmbledhës. Mungojnë deklaratat për konfliktin e interesit.

-AK ka marrë për shqyrtim oferta, të cilat nuk janë të protokolluara, si dhe për më tepër, data e një oferte është 17.05.2016, ndërkohë që kjo procedurë është zhvilluar datë 14.12.2016.

-Objektet në ofertat e dhëna, nuk janë të njëjta me objektin për procedurën që AK ka zhvilluar.

-Në ofertën e dhënë nga një shoqëri konfirmohet se, përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në seksionin “kushtet e përgjithshme”, ndërkohë që kushte të përgjithshme nuk ekzistojnë.

-Ofertat e OE janë mbi vlerën e fondit limit, si dhe në këto kushte, procedura e zhvilluar duhej të ishte anuluar (*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 10, faqe 130-131*).

Rekomandimi 6:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 2,020,000 lekë, përkatësisht nga Z. F. B, në cilësinë e titullarit të autorizuar të AK dhe personat e tjerë përgjegjës.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Eventi në lidhje me Fushatën Publicitare për sensibilizimin e opinionit publik në lidhje me të drejtat e pasagjerëve dhe detyrimet e tyre (**blerje posterash, fletëpalosje, hostes etj**)”, sipas kontratës së nënshkruar Nr. 1652/14 Prot., datë 15.12.2016, **është konstatuar dëm ekonomik në vlerën 4,475,000 lekë**, si rezultat i **procedurës fiktive të ndjekur nga AK**. Kjo për arsye se:

-Nuk është argumentuar nevoja e kryerjes dhe përfitimet e mundshme të këtij shpenzimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 4 “Fusha e zbatimit” dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26.

-Nuk është planifikuar në programin ekonomik të vitit 2016, por është bërë ndryshim në fund të vitit me qëllim përdorimin e të ardhurave të papërdorura, ndryshim ky i pa argumentuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Aviacionin Civil”, i ndryshuar, neni 18, pika 3.

-Fondi limit nuk është i argumentuar dhe i dokumentuar.

-Anëtarët e grupit të punës nuk kanë kualifikimet dhe eksperiencën, në zhvillimin e kësaj procedure.

-Ofertat e OE janë mbi vlerën e fondit limit, si dhe në këto kushte, procedura e zhvilluar duhej të ishte anuluar, si dhe nuk duhej të ishte bërë miratimi i raportit përmbledhës nga titullari i autorizuar i AK.

-Kontrata për objektin e mësipërm të prokurimit është nënshkruar në datë **15.12.2016**, për procedurën e zhvilluar në datë **14.12.2016**, si dhe formulari i sigurimit të kontratës mban datën **16.12.2016**, në kundërshtim me nenin 58/5 të LPP, si dhe nenet 11/1/2, 21/1/2, 24 të VKM.

-AK ka zhvilluar një procedurë, duke u shmangur nga përdorimi i Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar.

-AK nuk ka përcaktuar asnjë model mbi elementët për ofertën që kërkohet, mosveprim ky i cili shkakton konfuzion mbi ofertat që do të paraqiteshin për këtë procedurë, duke mos i vënë shoqëritë e ftuara në kushte të barabarta konkurrimi dhe vlerësimi.

-AK, ka nënshkruar një kontratë Nr. 1652/14 Prot., datë 15.12.2016, me vlerë totale 4,475,000 lekë, ku në nenin 3.1 të saj parashikohet se: “Zbatimi i kontratës duhet të fillojë me nënshkrimin e saj, me kohëzgjatje për dorëzimin e punimeve deri në datë **15.01.2016**”, ndërkohë që kontrata është nënshkruar në datë 15.12.2016.

-Mungojnë deklaratat për konfliktin e interesit.

-AK ka marrë për shqyrtim oferta, të cilat nuk janë të protokolluara në AK.

-Ka ndërhyrje në ofertën fituese (ndryshim vlere). Kjo për faktin se, oferta e dhënë nga shoqëria fituese është 4,475,000 lekë pa TVSH, ndërkohë që AK ka ndërhyrë në ofertën e kësaj shoqërie, duke zbritur në mënyrë antiligjore TVSH-në, duke përcaktuar se vlera është 3,729,167 lekë pa TVSH, pra për ta kthyer në një ofertë të vlefshme, nën vlerën e fondit limit (*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 11, faqe 132-133*).

Rekomandimi 7:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **4,475,000 lekë**, përkatësisht nga Z. F. B në cilësinë e titullarit të autorizuar të AK dhe personat e tjerë përgjegjës.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar për zbatimin e kontratës së lidhur me objekt: “Realizimi i studimit të fizibilitetit për ndërtimin e një aeroporti në jug të vendit”, sipas kontratës së nënshkruar 1573/1 Prot., datë 27.11.2017, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën 473,088 lekë**, si rezultat i procedurës së parregullt të ndjekur nga AK, në kundërshtim me kushtet e kontratës. Theksojmë se, kjo vlerë është përlllogaritur deri në datën 02.03.2018, **datë në të cilën përfundon edhe auditimi në AAC. AK ka detyrimin ligjor, lidhur me likuidimin e dëmeve për dorëzimin e vonuar, të përlllogarisë vlerën përkatëse për ditët në vijim.** Në rast se projekti përfundimtar i plotë i studimit të fizibilitetit **nuk do të dorëzohet brenda afatit 20.03.2018**, atëherë AK duhet të zbatohet penalitetet përkatëse, sipas kushteve të kontratës **ndaj kontraktorit** (*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 12, faqe 133-134*).

Rekomandimi 8:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 473,088 lekë, përkatësisht nga shoqëria “SC&R”.

9. Gjetje nga auditimi: Më datë 19.09.2016 është blerë sipas procedurës së zhvilluar me blerje të vogël, një televizor për zyrën e Drejtorit me vlerë **59,000 lekë** me tvsh, i cili për shkak të një defekti teknik është nxjerrë jashtë përdorimit. Nga auditimi në magazinën e AAC u konstatua se, televizori i bërë hyrje në magazinë, si televizor i dëmtuar, ishte i ndryshëm nga malli i blerë tek operatori ekonomik “AZ” SH.P.K, krahasuar me specifikimet teknike të tij. Ky mall është likuiduar sipas faturës tatimore nr. 530, datë 19.09.2016. Sa më sipër, **vlera 59,000 lekë përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit** (*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 13, faqe 134*).

Rekomandimi 9:

Nga Drejtori Ekzekutiv të nxirren përgjegjësitë, si dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **59,000 lekë** nga personat përgjegjës, për dëmin e shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së zhvilluar me objekt “Për blerje bileta udhëtimi transporti ajror” u konstatua se, më datë **06.09.2017**, ka dalë Urdhri i Prokurimit për zhvillimin e kësaj procedure. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se, ka mospërputhje midis urdhrin për nisjen e procedurës së prokurimit me datë 06.09.2017, me ofertat e marra nga operatorët të cilat kanë ardhur me datë **09.08.2017**. Fitues është shpallur operatori ekonomik “AT and T” me ofertën **275,900 lekë**. Pra ofertat kanë ardhur 28 ditë para se të dilte urdhri për kryerjen e kësaj procedure, çka sjell kryerjen e një procedure “fiktive” nga ana e AAC, e për pasojë, **vlera 275,900 lekë përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit** (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 14, faqe 134-135).

Rekomandimi 10:

Nga Drejtori Ekzekutiv, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 275,900 lekë nga z. A.K, znj. D.M dhe z.K.S në cilësinë e anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlera të vogla, për dëmin e shkaktuar në procedurën e zhvilluar me objekt “Për blerje bileta udhëtimi transporti ajror”.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së zhvilluar me objekt “Për blerje bileta udhëtimi transporti ajror” u konstatua se, në datën 12.09.2017 ka dalë Urdhri i Prokurimit. Nga dokumentacioni u konstatua se, ka një parregullsi në përputhje me urdhrin për nisjen e procedurës së prokurimit me datë 12.09.2017 dhe ofertat e marra nga operatorët, të cilat kanë ardhur me datë 10.09.2017. Fitues është shpallur operatori ekonomik “DK” me ofertën 62,980 lekë, pra ofertat kanë ardhur 2 (dy) ditë para se të nxirrej urdhri për kryerjen e kësaj procedure çka sjell kryerjen e një procedure “fiktive”, e për pasojë, **vlera 62,980 lekë përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit** (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 15, faqe 135).

Rekomandimi 11:

*Nga Drejtori Ekzekutiv, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **62,980 lekë** nga z. A.K, znj. D.M dhe z. K.S në cilësinë e anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlera të vogla, për dëmin e shkaktuar në procedurën e zhvilluar me objekt “Për blerje bileta udhëtimi transporti ajror”.*

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së zhvilluar me objekt “Për blerje kartvizitash, licencash dhe çeklistat” u konstatua se, në datën 10.02.2017 ka dalë Urdhri i Prokurimit. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi testoi tregun, duke u bazuar në kriterin e çmimit më të ulët, ka përzgjedhur si fitues operatorin ekonomik “E-P” SH.P.K. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion është konstatuar se, personat që kanë marrë në dorëzim kartvizitat kanë firmosur proces verbalin e dorëzimit me datën 15.03.2017, kur fatura tatimore e shitjes mban datën 17.03.2017, pra kanë firmosur marrjen në dorëzim të mallit 2(dy) ditë para se ai të shitej nga operatori ekonomik, çka sjell kryerjen e një procedure “fiktive” nga ana e AAC. Gjithashtu është konstatuar shkelje e legjislacionit në fuqi për arsye se, pagesa për këto mallra është kryer dhe pse nuk ekziston asnjë faturë hyrje dhe faturë dalje në magazinë, pra nuk është i mundur vërtetimi që kartvizitat, licensat dhe “checklistat” të jenë marrë në dorëzim nga punonjësit e AAC-së, për pasojë **vlera 108,600 lekë përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit** (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 16, faqe 135-136).

Rekomandimi 12:

Nga Drejtori Ekzekutiv, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 108,600 lekë nga z. FG, z. AK dhe z. KS në cilësinë e anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlera të vogla, për dëmin e shkaktuar në procedurën e zhvilluar me objekt “Për blerje kartvizitash, liçensash dhe çeklista”.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së zhvilluar me objekt “Blerja ose marrja me qira, për zbukurimin dhe dekorimin e ambienteve të AAC-së me rastin e festave të fundvitit” u konstatua se me datë 16.12.2016 ka dalë Urdhri i Brendshëm. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Shërbimeve, Drejtoria Ekonomike si edhe grupi i punës i cili përbëhet nga znj. HÇ Kryetare, znj.ED anëtare, znj. L R anëtare, znj. E Sh anëtare, znj. SR anëtare.

Me faturën tatimore nr. 29, datë 23.12.2016 me vlerë 480,000 lekë me tvsh është likuiduar “SD” SH.P.K Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se dhe pse kontrata mes AAC dhe operatorit ekonomik “SD” Sh.p.k është lidhur me datën 16.12.2016 për dhënien me qira të zbukurimeve për periudhën e festave të fundvitit, grupi i punës në proces verbalin e firmosur prej tyre me datën 06.01.2017 bazuar në kriterin e çmimit më të ulët ka përzgjedhur si fitues operatorin ekonomik “SD” Sh.p.k dhe ka marrë në dorëzim mallrat sipas kontratës. Vihet re se shpallja e operatorit fitues dhe marrja në dorëzim e mallrave është kryer 15 ditë pasi është paguar operatorit ekonomik, çka sjell kryerjen e një procedure “fiktive” nga ana e AAC për pasojë **vlera 480,000 lekë përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit** (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 17, faqe 136).

Rekomandimi 13:

Nga Drejtori Ekzekutiv, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 480,000 lekë nga z.F. G në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike, znj. H.Ç, znj. E.D dhe znj. S. R në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim, për dëmin e shkaktuar në procedurën e zhvilluar me objekt “blerja ose marrja me qira,për zbukurimin dhe dekorimin e ambienteve të AAC-së me rastin e festave të fund vitit”.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së zhvilluar me objekt “blerja dhe shpërndarja e dhuratave (shportave) për Institucionet qeverisëse dhe Institucionet e tjera në marrëdhënie të ngushta me AAC, dhurata për fëmijët e punonjësve të AAC, si dhe marrjen e masave për festën e fund vitit” u konstatua se, me datë 16.12.2016 ka dalë Urdhri i Brendshëm. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Shërbimeve, Drejtoria Ekonomike si edhe grupi i punës i cili përbëhet nga znj. H.Ç Kryetare, znj. E.D anëtare, znj. L. R anëtare, znj. E.Sh anëtare, znj.S.R anëtare.

Me faturën tatimore nr. 38, datë 28.12.2016 me vlerë 368,000 lekë me TVSH është likuiduar “SD” Sh.p.k për blerje lodrash dhe paketim dhuratash për fëmijët e punonjësve të AAC. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk disponohet asnjë kontratë e nënshkruar mes AAC dhe “SD” Sh.p.k, për lodrat e fëmijëve. Gjithashtu, nga verifikimi i firmave të punonjësve që kanë marrë dhuratat për fëmijët e tyre u konstatua se, në disa raste, në pamje vizive, nënshkrimet nuk janë të personave në fjalë (krahasuar kjo me dokumente të tjera zyrtare të nënshkruara prej tyre, duke mos vërtetuar dot identitetin e tyre).

Me faturën tatimore nr. 3107, datë 27.12.2016 me vlerë 130,000 lekë me TVSH është likuiduar “AD” Sh.p.k për blerjen e 233 shisheve verë. Me faturën tatimore nr. 3105, datë 27.12.2016 me vlerë 438,000 lekë me TVSH është likuiduar “AD” Sh.p.k për blerjen e 72

shisheve verë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion është konstatuar shkelje e legjislacionit në fuqi pasi pagesa për këto mallra është kryer dhe pse nuk ekziston asnjë faturë hyrje dhe asnjë faturë dalje, pra nuk është i mundur vërtetimi që lodrat dhe shishet e verës për formimin e dhuratave (shportave) të jenë marrë në dorëzim nga punonjësit e AAC-së, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, e cila citon “Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, çka sjell kryerjen e një procedure “fiktive” nga ana e AAC, për pasojë **vlera 936,000 lekë përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit** (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 14, faqe 136-137).

Rekomandimi 14:

*Nga Drejtori Ekzekutiv, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **936,000 lekë** nga z. FG në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike, znj. HÇ, znj. ED, znj. ESh, Znj. L R dhe znj. SR në cilësinë e anëtareve të grupit të punës, për dëmin e shkaktuar në procedurën e zhvilluar me objekt “Blerja dhe shpërndarja e dhuratave (shportave) për Institucionet qeverisëse dhe Institucionet e tjera në marrëdhënie të ngushta me AAC, dhurata për fëmijët e punonjësve të AAC, si dhe marrjen e masave për festën e fund vitit”.*

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së zhvilluar me objekt “darkë për punonjësit e AAC me rastin e festës të fund vitit” u konstatua se, me datë 16.12.2016 është lëshuar Urdhri i Brendshëm. Me urdher shpenzimin nr. 505, datë 13.01.2017 është paguar vlera 353,000 lekë me tvsh për R H.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për darkën e realizuar me rastin e festës së fundvitit në ambientet e R H rezulton se, grupi i punës ka pranuar ofertën e RH si ofertuesi me menynë më të lirë (3,500 lekë për person). Në dosjen e kësaj procedure nuk ekziston dokument që të vërtetojë ekzistencën e ndonjë ofertuesi tjetër për mbarrëvajtjen e këtij evenimenti. Kjo darkë është përllogaritur për 120 pjesëmarrës maksimalisht, një shifër njerëzish e pajustificuar pasi numri i punonjësve të AAC-së është 66 veta (nga listë-pagesa e muajit dhjetor 2016), referuar kjo objektit tuaj ku është shkruar se kjo darkë është vetëm për punonjësit e AAC-së. Në proces verbalin e firmosur nga grupi i punës është konstatuar se në darkën e organizuar nga 120 persona të planifikuar kanë marrë pjesë 101 veta ndaj fatura përfundimtare e mbrëmjes është 101 x 3,500 (lekë për person) = 353,500 lekë.

Për grupin e auditimit është e pajustificuar rritja e numrit të pjesëmarrësve në këtë event ndaj vlera që duhej të paguhej nga AAC është: 66 x 3,500 lekë= 231,000 lekë, **për pasojë vlera 122,500 lekë përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit** (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 19, faqe 137-138).

Rekomandimi 15:

*Nga Drejtori Ekzekutiv të nxirren përgjegjësitë, si dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **122,500 lekë** nga personat përgjegjës, për dëmin e shkaktuar në procedurën e zhvilluar me objekt “darkë për punonjësit e AAC me rastin e festës të fund vitit”.*

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë është konstatuar se me faturën tatimore nr. 90 datë 22.05.2017 është paguar vlera 27,500 lekë me TVSH ndaj Kantinës “Gj” për blerjen e 25 shisheve konjak dhe 25 shisheve verë si dhuratë simbolike me rastin e mbylljes së bashkëpunimit EASA-IPA3. Ky veprim është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për arsye të shmangies nga procedurat e prokurimit elektronik. Është konstatuar se, Urdhri i Brendshëm për blerjen e dhuratave për pjesëmarrësit

në këtë aktivitet është lëshuar me datën 31.05.2017 kurse fatura tatimore e lëshuar për blerjen e 25 shisheve konjak dhe 25 shisheve verë mban datën 22.05.2017, pra 9 (nëntë) ditë para se të dilte urdhri i brendshëm çka sjell zhvillimin e një procedure “fiktive” nga ana e AAC, **për pasojë vlera 27,500 lekë përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit** (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 20, faqe 138).

Rekomandimi 16:

Nga Drejtori Ekzekutiv, të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 27,500 lekë nga znj. LR në cilësinë e titullarit të AK, si dhe z. FG në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike për dëmin e shkaktuar.

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera me bankë është konstatuar se pagesat nga AAC, për përballimin e shpenzimeve për udhëtim e dieta të punonjësve që shkojnë me shërbim jashtë vendit, ka gjetur zbatim VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. Shpenzimet e fjetjes, të transportit dhe dieta në ngarkim të shtetit, në përgjithësi janë të dokumentuara me faturat përkatëse (fatura, bileta etj.), dhe pagesat janë bërë në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Për periudhën objekt auditimi është konstatuar se në shumicën e rasteve faturat e hotelit si dhe të taksive nuk e vërtetojnë shpenzimin, pasi janë pa vullë vërtetuese, çka bën që dokumentacioni i paraqitur mos të justifikojë shpenzimin, **për pasojë vlera totale e tyre prej 41,293 euro përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit** (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 21, faqe 138-139).

Rekomandimi 17:

Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv, të shqyrtojnë vlerën 41,293 euro, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në pagesave të kryera me bankë për përballimin e shpenzimeve për udhëtim e dieta të punonjësve që shkojnë me shërbim jashtë vendit, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

C.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Me datë 04.04.2017 me shkresën me nr. 1799/3 Drejtorit Ekzekutiv së AAC-së znj. L R i është dërguar shkresa nga Ministri i MTI për marrjen e masave për organizimin e një dreke në ambientet e aeroportit “Nënë Tereza” si dhe mbulimin e shpenzimeve nga ana e AAC-së. Me faturën tatimore me nr. 44256901, datë 05.04.2017 është paguar vlera 81,000 lekë me TVSH ndaj “D” Sh.p.k për shërbim katering.

Në përputhje me programin e bashkëpunimit EASA-IPA3, është konstatuar se gjatë muajve shkurt-qershor të vitit 2017 janë ofruar shërbime të ndryshme për dreka dhe darka për trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja. Vlera totale e drekeve dhe darkave është 247,270 lekë me TVSH. **Në të dyja këto procedura është konstatuar shkelje e LPP-së** për shkak se këto procedura janë shmangur nga prokurimi publik elektronik veprim ky në kundërshtim me nenin 1 të ligjit me nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Vlera **328,270 lekë përbën efekt financiar negativ për llogari të Buxhetit të Shtetit** (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 5, faqe 140).

Rekomandimi 1:

Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv, të shqyrtojnë vlerën 328,270 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurat e organizimit dhe shërbimit të drekave për arsye pune, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e Shtetit.

6. HEKURUDHA SHQIPTARE SHA, DURRËS.

Auditimi është kryer ne bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1223 prot., datë 31.10.2018, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtuar në “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës.

Nga auditimi i ushtuar në Shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 01.11.2014 deri më datën 31.12.2017, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 50, datë 17.06.2018 t Kryetarit t KLSH-s të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1313/11 prot, datë 18.06.2018, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Hekurudha Shqiptare”, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresë 1313/13 prot., datë 29.06.2018 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit”.

Për sa më sipër është hartuar plani i veprimit për detyrat e lëna nga KLSH i miratuar nga Drejtori i institucionit me afate dhe personat e drejtoritë përgjegjëse për ndjekjen e tyre. *Për secilën masë organizative, të ç’dëmtimit dhe disiplinore janë nxjerrë urdhrat përkatës nga drejtori i institucionit, për zbatimin e detyrave të rekomanduara.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

A. Masa organizative: Janë rekomanduar 23 masa organizative gjithsej të cilat janë pranuar të gjitha ose 100% e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 4 dhe janë në proces zbatimi 19.

B. Masa shpërblim dëmi: Janë rekomanduar gjithsej 9 masa për shpërblim dëmi ekonomik të arkëtueshëm në vlerën 30,427 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 9 ose 100 % e tyre. Zbatimi i këtyre rekomandimeve është në proces.

Shënim: Rekomandimet 4.1 dhe 4.2, janë revokuar sipas shkresës nr. 1313/15 prot., datë 01.08.2018 për vlerën 7,738 lekë, por jo gjetjet 4 dhe 5.

C. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike nga 5 rekomandime gjithsej në vlerën 1,474,183 mijë lekë, janë pranuar 5 të cilat janë në proces shqyrtimi.

C. Masa me karakter disiplinor. Nga 16 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej (një masë është paraqitur me gabim në emër) janë pranuar të gjitha dhe janë zbatuar.

Shoqërisë “Hekurudhës Shqiptare” SHA Durrës, nuk do ti drejtohem për të inkurajuar përsheptimin e zbatimit të masave që janë në proces.

7. UJËSJELLËS KANALIZIME, SHKODËR.

Auditimi është kryer ne bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1223 prot., datë 31.10.2018, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtuar në “Ujësjellës Kanalizime” SHA Shkodër.

Nga auditimi i ushtuar në Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA Shkodër, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2015 deri më datën 30.06.2017, trajtuar në Raportin

Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 195, datë 27.12.2017 t Kryetarit t KLSH-s të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 737/13 prot, datë 29.12.2017, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Ujësjetës Kanalizime” SHA Shkodër, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresë 490 prot., datë 26.01.2018 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit”.

Për sa më sipër është hartuar plani i veprimit për detyrat e lëna nga KLSH i miratuar nga Drejtori i institucionit me afate dhe personat e drejtoritë përgjegjëse për ndjekjen e tyre. *Për secilën masë organizative, të ç’dëmtimit dhe disiplinore janë nxjerrë urdhrat përkatës nga drejtori i institucionit, për zbatimin e detyrave të rekomanduara.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

A. Masa organizative: Janë rekomanduar 39 masa organizative gjithsej të cilat janë pranuar të gjitha ose 100% e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 7, janë zbatuar pjesërisht 5 dhe janë në proces zbatimi 27.

B. Masa shpërblim dëmi: Janë rekomanduar gjithsej 4 masa për shpërblim dëmi ekonomik të arkëtueshëm në vlerën 1,930 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 4 ose 100 % e tyre. Zbatimi i këtyre rekomandimeve është në proces.

C. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike nga 10 rekomandime gjithsej në vlerën 55,322 mijë lekë, janë pranuar 10 të cilat janë në proces shqyrtimi.

C. Masa me karakter disiplinor. Nga 19 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej, janë pranuar të gjitha dhe janë zbatuar 18.

Shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime” SHA Shkodër, nuk do ti drejtohem për të inkurajuar përsheptimin e zbatimit të masave që janë në proces.

8. REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE, NR. 2, TIRANË” SH.A.

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1223 prot., datë 31.10.2018, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtuar në “Rezidencën Studentore Universitare, Nr. 2, Tiranë” Sh.A. (*ish “Trajtimi i Studentëve, Nr.2”, Tiranë*).

Nga auditimi i ushtuar në “Rezidencën Studentore Universitare, Nr. 2, Tiranë” sha, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2015 deri më datën 30.06.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 159 dat 22.11.2017, t Kryetarit t KLSH-s të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 770/10 prot, datë 22.11.2017, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Rezidenca Studentore Universitare, Nr. 2, Tiranë” sh.a, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 494 prot, datë 11.12.2017 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit nr. 770/10, datë 22.11.2017”.

Për sa më sipër, është hartuar plani i masave me nr. 494/1 prot. datë 11.12.2017 nga ish-Administratori i Trajtimi i Studentëve Nr. 2, sh.a Tiranë me afate dhe personat e drejtoritë përgjegjëse për ndjekjen e tyre. Për secilën masë organizative, të ç’dëmtimit dhe disiplinore janë nxjerrë urdhrat përkatës nga Administratori i shoqërisë Trajtimi i studentëve Nr. 2, për zbatimin e detyrave të rekomanduara.

Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a Tiranë, ka

kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 515 prot datë 07.05.2018, duke zbatuar afatin 6-mujor për raportimin mbi ecurinë e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

A. Masa organizative: Janë rekomanduar 7 masa organizative gjithsej të cilat janë pranuar të gjitha ose 100% e tyre. Nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1, është zbatuar pjesërisht 1, janë në proces zbatimi 5.

B. Masa shpërblim dëmi: Janë rekomanduar gjithsej 4 masa për shpërblim dëmi në vlerën 492 mijë lekë, të cilat janë pranuar të gjitha ose 100% e tyre. Nga masat e pranuar është arkëtuar 1 në vlerën 108 mijë lekë, si dhe janë në proces zbatimi 3 në vlerën 384 mijë lekë.

Shënim: Fillimisht kanë qenë rekomanduar 5 masa shpërblim dëmi në vlerën 1,644 mijë lekë, por rekomandimi 1.1 është revokuar sipas shkresës nr. 504/1 prot., datë 14.05.2018 të KLSH, për vlerën 1,152 lekë dhe quhet i ezauruar.

B.2. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efijencë dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë 2 rekomandime në vlerën 53,899 mijë lekë, nga të cilat, është në proces zbatimi 1 në vlerën 22,930 mijë lekë dhe nuk është zbatuar 1 në vlerën 30,969 mijë lekë.

C. Masa me karakter disiplinor. Nga 20 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej janë pranuar të gjitha nga të cilat janë zbatuar plotësisht 16 dhe janë zbatuar pjesërisht 4.

REKOMANDIMET

Në përfundim rikërkojmë nga shoqëria “Rezidencën Studentore Universitare, Nr. 2, Tiranë” sh.a, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 770/10 prot, datë 22.11.2017, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2015 deri më datën 30.06.2017, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, edhe pse ka kaluar afati 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

B. 2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Gjetje nga auditimi 1: - Për periudhën janar 2015 deri dhjetor 2015, për largime nga puna pa shkaqe të përligjura, nga ana e Shoqërisë është likuiduar vlera 22,560,282 lekë. Kjo vlerë përfshin dëmshpërblim page me vlerë 20,164,467 lekë, shpenzime gjyqësore me vlerë 972,000 lekë, tarifa përmbartimore me vlerë 1,323,978 lekë dhe shpenzime përmbartimore me vlerë 99,458 lekë.

Për periudhën janar 2016 deri dhjetor 2016, për largime nga puna pa shkaqe të përligjura, nga ana e Shoqërisë është likuiduar vlera 8,408,889 lekë. Kjo vlerë përfshin dëmshpërblim page me vlerë 7,353,160 lekë, shpenzime gjyqësore me vlerë 611,507 lekë, tarifa përmbartimore me vlerë 374,021 lekë dhe shpenzime përmbartimore me vlerë 70,200 lekë.

Rezulton se në pjesën më të madhe të rasteve, punonjësit e larguar nga puna të cilët kanë fituar dëmshpërblim nga gjykata, kanë aplikuar direkt tek përmbartimi dhe nuk kanë kërkuar zbatimin e vullnetshëm të shoqërisë në likuidimin e pagesave, duke i kushtuar më shumë shoqërisë kosto përmbartimore me vlerë 169,658 lekë.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar, neni 146, pika 3, ku përcaktohet: “Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme. Punëdhënësi që ka zgjidhur kontratën pa shkaqe

të arsyeshme, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim gjykate të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim”.

Sa më sipër, për periudhën objekt auditimi, si pasojë e largimeve të punonjësve nga puna pa shkaqe të përligjura, Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve 2” i është shkaktuar efekt negativ financiar me vlerë 30,969,171 lekë (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 1, faqe 211).

Rekomandimi 1: Shoqëria Studentët nr. 2 SHA Tiranë, të analizojë largimet e paligjshme nga puna dhe të marrë masa për rishikime të argumentuara, për shmangien e pasojave financiare sa i përket shoqërisë dhe sociale sa i përket punonjësve që largohen padrejtësisht nga puna dhe punësimet e panevojshme.

9. ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, TIRANË

Auditimi është kryer në bazë të shtesës së programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1223/10 prot., datë 20.11.2018, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në “Entin Kombëtar të Banesave”, Tiranë. Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave, me objekt për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të KLSH “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.06.2016 deri në datën 31.12.2017, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 127, datë 10.09.2018 të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë në subjekt me shkresën Nr. 477/10 datë 13.09.2018, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 1865/1 prot., datë 05.10.2018 “Informacion mbi zbatimin e masave dhe rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 477/10 datë 13.09.2018”.

Këshilli Drejtues i EKB-së, në mbledhjen e tij të rrallës ka miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.10.2018, planin e veprimit të hartuar nga drejtoria e përgjithshme në zbatim të detyrave të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Vendim i cili i është përcjellë EKB-së me shkresën nr. 2128/1 prot datë 29.10.2018. Për secilën masë organizative, shpërblim dëmi janë nxjerrë urdhrat respektiv nga Drejtori i Përgjithshëm, për zbatimin e detyrave të rekomanduara.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave, Tiranë nuk e ka përmbushur afatin 6-mujor të raportimit pasi në fazën e përpilimit të këtij raporti auditimi për këtë subjekt nuk është plotësuar ky afat.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar, konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

A. Masa organizative: Janë rekomanduar 19 masa organizative gjithsej nga të cilat janë pranuar 16 masa ose 84.2% dhe nuk janë pranuar 3 masa ose 15.8% e tyre. Nga masat e pranuar janë në proces zbatimi 16 masa.

B. Masa shpërblim dëmi: Janë rekomanduar gjithsej 9 masa për shpërblim dëmi në vlerën 4,459 mijë lekë, të cilat janë pranuar të gjitha ose 100% e tyre. Nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1 për vlerën 265 mijë lekë dhe janë në proces zbatimi 8 për vlerën 4,194 mijë lekë.

B2. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve

publike: Janë rekomanduar 7 masa për vlerën 61,470 mijë lekë nga të cilat nga të cilat janë pranuar 5 masa në vlerën 57,024 ose 71.4 % e tyre dhe nuk janë pranuar 2 në vlerën 4,446 mijë lekë ose 28.6%. Masat e pranuar janë të gjitha në proces zbatimi.

C. Masa Administrative: Është rekomanduar 1 masë, e cila është pranuar dhe është zbatuar.

D. Masa me karakter disiplinor. Nga 5 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej janë pranuar 3 masa ose 60% e tyre dhe nuk janë pranuar 2 masa ose 40% e tyre. Nga masat e pranuar, është zbatuar plotësisht 1 dhe janë zbatuar pjesërisht 2.

REKOMANDIMET

Në përfundim rikërkojmë nga Drejtoria e Përgjithshme e “Entit Kombëtar të Banesave”, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 477/10 prot, datë 13.09.2018, mbi auditimin me objekt “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare*”, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.06.2016 deri në datën 31.12.2017, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 127, datë 10.09.2018 të Kryetarit të KLSH-së, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara edhe pse nuk ka kaluar afati 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje nga auditimi 1: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me vendimet e Këshillit Drejtues të EKB dhe konkretisht të vendimeve:

-Nr. 37, datë 28.12.2016, mbi “Vënien në funksionim të ashensorit në objektin Banesa tip 83/5, 8 kate me 35 apartamente në qytetin Kavajë”, u konstatua se ky ashensor, është montuar, kolauduar dhe marrë në dorëzim nga EKB, në kohën që është ndërtuar (investuar nga EKB) godina e banimit në vitin 2009.

-Nr. 18, datë 03.08.2016, mbi “Miratimin e apartamentit të dëmtuar në objektin e ndërtuar nga EKB në qytetin e Korçës”, u konstatua se është miratuar kryerja e një investimi për riparim të banesës së dëmtuar në qytetin e Korçës, (godinë/banesë e cila ishte ndërtuar, kolauduar, dorëzuar dhe shitur në vitin 2007) në vlerën e 648,859 lekë. Drejtoria e Entit Kombëtar të Banesave, nuk ka kryer asnjë procedurë prokurimi me objekt “Riparim banese”. Nuk ka analizuar rrethanat dhe shkaqet e ndodhjes së aksidentit duke mos nxjerr konkluzionet dhe përgjegjësitë e personave sipas rrethanave por ka miratuar disbursimit e shumës pa baza ligjore. Si rrjedhojë, nuk mund të anashkalohet nxjerrja e përgjegjësisë dhe gjetja e shkaqeve të dëmtimit nëse ka qenë defekt i ardhur nga investimi fillestar apo nga keqpërdorimi i apartamentit. Nga momenti i kolauditimit dhe dorëzimit të godinave të banimit, të ndërtuara nga EKB, nuk mund të ri-investohet për mirëmbajtje apo riparime vetëm sepse godinat apo banesat pësojnë dëmtime. Këshilli Drejtues, Drejtoria e Përgjithshme e EKB, nuk duhej të ndërmerrenin iniciativa për investime apo pagesa në kundërshtim me vet qëllimin e EKB që është investimi për ndërtim banesash sociale (jo mirëmbajtje apo riparim) me qëllim përfitimin ekonomik siç përcaktohet qartazi tek statuti dhe rregullorja e brendshme e EKB.

-Nga auditimi i strukturës organizative të EKB dhe Rregullores së brendshme, konstatohet se EKB, nuk funksionon sipas një hierarkie siç përcaktohet në Ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”. Konkretisht, i gjithë stafi i EKB, raporton tek Drejtori i Përgjithshëm, por jo të gjithëve mund tu kërkohet përgjegjësi ose mund tu tërhiqet vërejtje nga Drejtori i Përgjithshëm i EKB. Drejtori i Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtori i EKB, varen direkt nga Ministri i Linjës. Këshilli Drejtues ka në varësi të gjithë drejtorët e drejtorive të EKB akoma dhe stafin e specialistëve. Duket, në plan të parë, se është i panevojshëm pozicioni i drejtorit të përgjithshëm të EKB aq më tepër ai i Zëvendësdrejtorit. Të gjithë drejtorët e drejtorive të EKB, bëjnë çdo lloj detyre që i ngarkohet

nga drejtori i përgjithshëm por nuk përcaktohet se kush merr masa administrative deri në largim nga puna. Këshilli Drejtues i merr këto masa në fakt, sipas përcaktimeve të pikës “k”, të nenit 14 të statutit të EKB, por me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm. Sa më sipër, përben shkak për një ngërç administrativ ose një vakum ligjor për vetë funksionimin institucional dhe arritjen e objektivave të EKB. Mungesa e llogaridhënies tek eprori direkt është një mangësi që ka sjellë si pasojë shmangien e përgjegjësive administrative të stafit të EKB. Enti Kombëtar i Banesave, funksionon si agjenci autonome, në kuptim të nenit. 20 të ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës Shtetërore”. Drejtorët e EKB, të Drejtorisë së Përgjithshme dhe atyre rajonale, kanë funksionuar pa llogaridhënie e administrative (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 2, faqe 221-223).

Rekomandimi 1: Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave, Këshilli Drejtues, të marrin masa që në të ardhmen, të mos marrin iniciativa për mirëmbajtje apo riparime me efekte negative financiare për vet institucionin në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Rekomandimi 1.1 : Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave, Këshilli Drejtues, të marrin masa që të analizojnë investimet e kryera më parë për mirëmbajtje dhe riparime, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive dhe marrjen e masave administrative për personat përgjegjës.

Gjetje nga auditimi 2: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt:

-“Banesë me kosto të ulët dhe efikasitet energjie, godina nr. 1 në qytetin e Korçës” me fond limit 69,544,571 lekë, sipas urdhrimit të prokurimit me nr. 1183 prot, datë 19.05.2016;

-“Banesë me kosto të ulët dhe efikasitet energjie, godina nr. 2 në qytetin e Korçës” me fond limit 177,975,710 lekë, sipas urdhrimit të prokurimit me nr. 660 prot, datë 10.08.2016;

-“Godinë banimi 6 kat +1 kat nëntokë në rrugën Stefan Kaçulini në qytetin e Durrësit” me fond limit 92,777,097 lekë, sipas urdhrimit të prokurimit me nr. 2490 prot, datë 03.11.2016;

-“Bllok banesash sociale me kosto të ulët dhe efikasitet energjie me dy kate + papafingo në qytetin e Pukës” me fond limit 61,113,825 lekë, sipas urdhrimit të prokurimit me nr. 1022 prot, datë 11.05.2017, u konstatua se:

-Në të gjitha rastet e mësipërme, EKB, përpara nënshkrimit të marrëveshjeve me Bashkitë respektive për ndërtimin e godinave të banimit, nuk disponon ndonjë relacion ose analizë tekniko-ekonomike lidhur me nevojat e bashkive për ndërtimin e objekteve të banimit referuar numrit të pastrehëve sipas komuniteteve përkatëse. Enti Kombëtar i Banesave, nuk ka asnjë të dhënë rreth mënyrës së përzgjedhjes së qytetit ku do të investohet. Në të gjitha rastet e vendimeve të marra nga Këshilli Drejtues i EKB për ndërtimin e banesave për të pastrehët, në dosjet e prokurimit, mungonin korrespondenca midis drejtorive rajonale të EKB, Bashkive respektive dhe Drejtorisë së Përgjithshme të EKB për të vënë në pah nevojat e vet qyteteve në varësi të numrit të të pastrehëve, për të ndërtuar banesa sociale me kosto të ulët. EKB, në të gjitha rastet, përpara fillimit të procedurave të prokurimit me objekt “Ndërtim godinash me kosto të ulët dhe efikasitet energjie”, nuk ka evidentuar, argumentuar arsyen e mos ndërtimit apo të mos investimit në fillim në Bashkinë e Tiranës, Bashki që ka vendin e parë për nga numri i të pastrehëve sipas komuniteteve dhe kategorive. EKB, në të gjitha rastet, përpara lidhjes së marrëveshjes me Bashkitë respektive ku do të kryhej investimi, nuk ka kërkuar të dhëna nga bashkitë për kategoritë e të pastrehëve. Nuk është marrë asnjë iniciativë paraprake për të analizuar riskun e vjeljes së investimit i cili është i lidhur ngushtë me perspektivën e çdo qendre banimi, me numrin e të pastrehëve apo edhe me planet afatgjata për zhvillim të zonave urbane aty ku mund të parashikohet nëse do ketë rritje apo zvogëlim të numrit të banorëve. Nuk mund të ketë asnjë garanci rimbursimi ose rikthimi i

shumës së investuar aq më tepër vjelja e fitimeve, nëse investohet thjesht sepse Bashkitë, vënë në dispozicion të EKB, një truall.

- Në të gjitha rastet për ndërtimin e godinave për shtresat në nevojë, EKB, përcaktimin e vlerës fillestare të investimit, nuk e ka bërë duke u bazuar në preventivat e punimeve që do të kryhen. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nuk u konstatua asnjë relacion tekniko-ekonomik tek i cili të pasqyrohej mënyra e përcaktimit të fondit limit ose e vlerës së investimit përpara miratimit të marrëveshjes me Bashkitë respektive ku do të kryhej investimi. Në të gjitha rastet, për ndërtimin e godinave të banimit në Pukë, Durrës, Korçë, etj., u konstatuan luhatje të vlerës së investimit nga vlera e përcaktuar në fillim të lidhjes së marrëveshjes e deri në vlerën finale që konkludon me shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik që do të kryejë punimet. EKB, në asnjë rast, vlerën fillestare të investimit, nuk e ka të bazuar me preventivin përkatës të punimeve e si rrjedhojë pas bërjes së projektit dhe nxjerrjes së preventivit, vlera fillestare ka pësuar ndryshime të cilat edhe pse në rënie të vazhdueshme, kanë qenë të pa argumentuara dhe jo në përputhje me udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016(*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 3, faqe 223-224*).

Rekomandimi 2: Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Teknike, të marrin masa që në të ardhmen, përpara miratimit të marrëveshjeve për ndërtim godinash për të pastrehët, të ndjekin logjikën hierarkike lidhur me qytetet që kanë prioritet për investim, duke plotësuar në fillim nevojat për strehim të Bashkive me numrin më të lartë të të pastrehëve e lidhur kjo me perspektivën afatgjatë të këtyre Bashkive për zhvillim.

A. 2 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Gjetje nga auditimi 1: Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave, me përfaqësues drejtorin znj. DA, dhe me miratimin e Këshillit Drejtues, ka lidhur një marrëveshje me Bashkinë Pukë (Draft Marrëveshje) sipas shkresës me nr. 1995 prot, datë 05.09.2016. Tek kjo marrëveshje bashkëpunimi mbi “*Zbatimin e projektit pilot për sistemin me strehim të shtresave në nevojë në Bashkinë Pukë*”, tek neni 2, pika a), citohet: “*EKB, të kryejë investimin në 24 banesa sociale sipas projektit që i bashkëlidhet kësaj marrëveshjeje me një vlerë financiare rreth 55 milionë lekë*”. Në planin ekonomik-financiar të vitit 2017, parashikohet që në qytetin e Pukës, të investohen 73,000,000 lekë. Si rezultat, EKB, nuk ka bërë një analizë rreth nevojave për apartamente për çdo qytet. EKB, nuk ka patur dijeni për numrin e të pastrehëve në çdo qytet përpara se të përcaktohej vlera e investimit. Duke mos patur mundësinë e krahasimit të numrit të të pastrehëve midis qyteteve, është e pamundur të vendosen prioritetet se ku dhe pse duhet investuar në Korçë dhe jo në Elbasan. Ku dhe pse duhet investuar në Pukë e jo në Tiranë. Pra, EKB, jo vetëm që nuk e ka të argumentuar përzgjedhjen e qytetit ku do të investohet por nuk ka të argumentuar as vlerën sipas fakteve të mësipërme. Nuk është bërë një studim lidhur me çmimin e apartamenteve për shitblerje për sipërfaqe shfrytëzimi në Pukë, në krahasim me çmimin e sipërfaqes së ndërtimit duke iu referuar të paktën udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 28.12.2016, “*Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitin 2016*”. Nuk ka ndonjë analizë ekonomike nga drejtoria ekonomike e EKB, ku të përcaktohej nëse EKB do të kishte më shumë leverdi të blinte banesa në qytetin e Pukës në tregun e lirë apo të ndërtonte me fondet e saj. E thënë ndryshe, përse të investohej në qytetin e Pukës pa ndjekur një logjikë dhe një plan afatgjatë të investimit në një zonë e cila nuk mund të ketë prioritet më të lartë se Tirana, Durrësi, Vlora e me radhë sipas numrit të të pastrehëve. EKB, duhet të hartonte e të

studionte me profesionalizëm se çfarë të mire ekonomike por edhe sociale do ti sillte qytetit të Pukës strehimi i 64 familjeve të cilat mund të trajtoheshin fare lehtë me procedurën e dhënies me qira dhe jo të përfitimit të kredisë pasi kriteri bazë duhet të ishte prioriteti i numrit të të pastrehëve sipas komuniteteve i koordinuar me të ardhmen e qytetit apo në përpjesëtim të drejtë me numrin e banorëve të qytetit. Referuar dhe faqes zyrtare të Bashkisë Pukë: <http://bashkiapuke.gov.al/bashkia-e-pukes/>, konstatohet përcaktimi i mëposhtëm: “Mbyllja e minierave apo dhënia e tyre me koncesion ka shtuar numrin e të papunëve në Pukë, duke e kthyer varfërinë në një problem akut për banorët e zonës. Për shkak të saj, një pjesë e mirë e popullatës ka migruar në drejtim të Shqipërisë së Mesme ose emigruar jashtë Shqipërisë. Të ardhurat nga emigracioni janë një burim i rëndësishëm mbijetese për këtë bashki”. Si rezultat, për më tepër që vetë të dhënat e Bashkisë Pukë, garantojnë në një farë mënyre mos likuidimin e kredive pasi situata ekonomike është e rënduar për shkak të papunësisë. EKB, nuk ka bërë ndonjë analizë risku për shumën e rënë dakord për shlyerje të detyrimeve nga Bashkia Pukë edhe pse Ministri i Linjës, është shprehur nga korrespondencat e evidentuara në dosje, se ky investim ka risk. EKB, në rastin e mësipërm, ka funksionuar si bankë duke i dhënë kredi Bashkisë Pukë pa patur asnjë bazë ligjore dhe pa iu referuar udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitin 2016”. Nga të dhënat e vëna në dispozicion grupit të auditimit dhe nga analiza e mësipërme, arrihet në konkluzionin se EKB, ka vendosur të investojë një vlerë të konsiderueshme pa kryer asnjë studim për të garantuar rimbursimin e shumës së investuar nga Bashkia Pukë pasi marrëveshja e lidhur, nuk ka asnjë bazë ligjore e si e tillë, nuk i jep të drejtën ligjore EKB, që të kërkojë shlyerjen e “Kredisë”. Si i tillë, ky investim në vlerën e **53,258,084 lekë**, përbën investim me efekt negativ financiar për buxhetin e Shtetit dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin znj. D A dhe Këshillin Drejtues të përbërë nga RGj, J B, A S, I P, TK, M Dh dhe E H (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 1, faqe 239).

Rekomandimi 1: Këshilli Drejtues i Entit Kombëtar të Banesave, Drejtoria e Përgjithshme, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike, të marrin masa që në të ardhmen, mos të akordojnë shuma në favor të Bashkive në formë huaje por të procedojnë për çdo investim, konform ligjeve dhe rregullave në fuqi në favor të shtresave në nevojë për strehim.

Gjetje nga auditimi 2: Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Studim Projektim zbatimi dy banesa tip me 6 dhe me 8 kate, me kosto të ulët dhe eficiencë energjie”, për të cilin është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit të projektimit ndërmjet ish Titullarit të AK znj. DA dhe studios së projektimit “S” ShPK, sipas aktit me nr. 1005 prot., datë 28.04.2016, me vlerë **4,446,000 lekë me TVSh** rezultoi se ky projekt është hartuar me të dhënave apriori me synimin për t’u zbatuar në vijimësi gjatë aktivitetit të EKB për ndërtimin e banesave sociale. Këto kërkesa jo vetëm që janë jo konkrete (për një terren të pa njohur në fakt), por diktojnë hartimin e një projekti i cili nuk garanton zbatueshmërinë e tij për shkak të të qenit me të dhëna apriori dhe të destinuar që, në rastin më të disfavorshëm, të çojnë në lindjen e domosdoshmërisë së rishikimit të projektit, detyrë kjo e cila nuk është parashikuar në termat e referencës në kontratën e shërbimit të konsulencës. Për një rishikim të tillë, nisur nga eksperiencia e mëparshme e EKB – së ku gjatë zbatimit të punimeve në investimin me objekt “Objekt banimi dhe shërbimesh 6 kate me 1 kat nën tokë ambiente shërbimi nën tokë” projekti është ripunuar me një kontratë shtesë në vlerën 690,000 lekë me TVSh, por mbi të gjitha nga mungesa e kushteve kontraktuale me projektuesin, çdo kontratë shtesë do të gjeneronte një dëm ekonomik (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 3, faqe 242).

Rekomandimi 2: Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave, të marrin masa që në të ardhmen, të mos prokurojnë shërbime projektimi për objekte tip pa patur më parë të

dhëna konkrete për tokën ku do ndërtohet, formacionin dhe parametrat tokësor dhe konfiguracionin e pronës me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve të shpenzuara në drejtim të shërbimeve të projektimit.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 10 të kontratës individuale, dhe nenet 37 dhe 144, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i rikërkojmë Drejtorisë së Përgjithshme të EKB – së që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH për periudhën 01.06.2016 deri më 31.12.2017, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Vërejtje për pushim nga puna”, për 2 punonjësit z. M Dh dhe znj.MM

1. z. MDh, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.

Për shkeljet e mëposhtme:

Mos marrjen e masave për aplikimin e penaliteteve në vlerën totale prej **1,592,873 lekë** për vonesa në përfundimin në afat të shërbimit të projektimit në një rast në objektin “*Studim Projektim zbatimi dy banesa tip me 6 dhe me 8 kate, me kosto të ulët dhe eficiencë energjie*”, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, Kreu III, pika 61, Pika 52 si dhe Rregulloren mbi Organizimin dhe Funksionimin e Entit Kombëtar të Banesave (EKB).

2. znj. MM, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Teknike.

Për shkeljet e mëposhtme:

A. Mos marrjen e masave në një rast, në objektin “*Ndërtimi i rrjetit inxhinierik FU, FEE dhe KUZ për banesën Tip 83.5, Lushnje*” të miratimit të ndryshimit të tabelës së volumeve përpara kryerjes në fakt dhe jo pas kryerjes së punimeve veprime këto në kundërshtim me Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, pika 3, 7 dhe 7.1 si dhe Rregulloren mbi Organizimin dhe Funksionimin e Entit Kombëtar të Banesave (EKB);

B. Mos marrjen e masave në dy raste, të shmangies së lidhjes së kontratave për shërbime të prokuruar më parë dhe përsëritjen e tyre, veprime këto të shoqëruara me efekte negative për buxhetin e EKB – së në vlerën 715,000 lekë pa TVSh. Konkretisht:

i. Nisja e një procedure prokurimi me objekt “*Studim gjeologjik për objektin që do të ndërtohet në Durrës*” dhe më tej lidhja e kontratës përkatëse me vlerë 25,000 lekë me TVSh, për një studim gjeologjik i cili ka qenë parashikuar për tu kryer më parë në kontratën e shërbimit me objekt “*Hartimi i studimit urbanistik pjesor dhe projekt zbatimit ‘Projekt për ndërtimin e objekt ndërtimi dhe shërbimesh 6 kate dhe 1 kat nën tokë’ në rrugë Stefan Kaçulini*” sipas aktit me nr. 520 prot., datë 22.02.2012 mes ish – Titullarit të AK, z. IP dhe “AC” ShPK me përfaqësues ligjor AD.

ii. Nisja e një procedure prokurimi me objekt “*Ripunim i projektit të godinës së banimit që do të ndërtohet në rrugën Stefan Kaçulini në qytetin e Durrësit*” për një ripunim nevoja për të cilin citohet se ka lindur nga ndryshimi i konfiguracionit të gjurmës së ndërtimit. Në fakt, referuar materialit fotografik të ndodhur në dosjen e projektuesit si dhe gjendjes faktike të rrugës kryesore përgjatë aksit rrugor të emërtuar rruga Stefan Kaçulini, në momentin e hartimit të këtij projekti, rruga ka qenë e ndërtuar së bashku me trotualet. Nga momenti i hartimit të projektit të parë, i cili është hartuar në bazë të kontratës së shërbimit të lidhur sipas aktit me nr. 520 prot., datë 22.02.2012 mes ish – Titullarit të AK, z.IP dhe “A C” ShPK e deri në momentin e implementimit të projektit, konfiguracioni i zonës nuk ka ndryshuar dhe gjurmët dokumentare të vëna në dispozicion nuk tregojnë qartë apo nuk justifikojnë domosdoshmërinë e lindjes së nevojës për një procedurë të re prokurimi me objekt “*Ripunim*”

i projektit të godinës së banimit që do të ndërtohet në rrugën Stefan Kaçulini në qytetin e Durrësit". Nga ana e Drejtorisë Teknike nuk janë marrë masa për verifikimin e dokumentacionit të plotë të hartuar që në projektin e parë pasi nga auditimi rezulton se ky konfiguracion nuk ka ndryshuar dhe gjendja dhe konfiguracioni i pronës është i njëjtë me atë ekzistues që në momentin e hartimit të projektit të parë në vitin 2012. Nga krahasimi i të dhënave të certifikatës për vërtetim pronësie me nr. 724655, të lëshuar me datë 13.07.2012, me ato të pasqyruara në lejen e ndërtimit të dhënë nga Bashkia Durrës ardhur në EKB sipas aktit me nr. 146 prot., datë 23.01.2018 rezulton se nuk ka ndryshim në sipërfaqe dhe nuk konkretizohet ndryshimi i konfiguracionit të pronës. Ndodhur në këto kushte, nuk ka lindur asnjë domosdoshmëri mbi kryerjen e kësaj procedure e si rrjedhojë e mos marrjes së masave mbi zbatimin e detyrimeve kontraktuale të një kontrate të mëparshme, konkretisht kontratës së lidhur sipas aktit me nr. 520 prot., datë 22.02.2012 mes ish – Titullarit të AK, z. IP dhe "A C" ShPK me përfaqësues ligjor AD, termave të referencës si pjesë integrale e kësaj kontratë, në Kreun II, Realizimi i Projektit, pikën 2.2 Rekomandime për projektuesin ku përcaktohet se:

2.2.1 Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku është përcaktuar studimi urbanistik;

2.2.2 Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia Durrës, seksioni i urbanistikës dhe nga kadastra; rezulton se vlera prej 690,000 lekë pa TVSh, e likuiduar sipas urdhër xhimit të datës 18.12.2017 përbën përdorim pa efektivitet eficient dhe ekonomikitet të fondeve të buxhetit të shtetit dhe njësisë së EKB – së.

10. PORTI DETAR VLORË" SH.A

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1223 prot., datë 31.10.2018, me objekt: "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtuar në "Portin Detar Vlorë" SH.A.

Nga auditimi i ushtuar në Shoqërinë "Porti Detar Vlorë" sh.a, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH "Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare", për periudhën e veprimtarisë 01.04.2015 deri më datën 31.10.2017, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 29, datë 23.04.2018 t Kryetarit t KLSH-s të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1133/8 prot, datë 24.04.2018, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", "Porti Detar Vlorë" sh.a, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 258/3 prot, datë 15.05.2018 "Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit nr. 1133/8, datë 24.04.2018".

Për sa më sipër është hartuar plani i veprimit për detyrat e lëna nga KLSH i miratuar nga Drejtori i Portit Vlorë me afate dhe personat e drejtoritë përgjegjëse për ndjekjen e tyre. *Për secilën masë organizative, të ç'dëmtimit dhe disiplinore janë nxjerrë urdhrat përkatës nga drejtori i shoqërisë Porti Detar Vlorë, për zbatimin e detyrave të rekomanduara.*

Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", "Porti Detar Vlorë" sh.a, ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 258/4 prot datë 24.10.2018, duke zbatuar afatin 6-mujor për raportimin mbi ecurinë e rekomandimeve të lëna nga KLSH. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

A. Masa organizative: *Janë rekomanduar 17 masa organizative gjithsej të cilat janë pranuar të gjitha ose 100% e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 2, janë në proces zbatimi 14 dhe nuk është zbatuar 1.*

B. Masa shpërblim dëmi: Janë rekomanduara gjithsej 6 masa për shpërblim dëmi ekonomik të arkëtueshëm në vlerën 2,977 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 5 ose 83% e tyre dhe nuk është pranuar 1 masë në vlerën 1,080 mijë lekë, ose 17% e tyre. Masat e pranuar janë të gjitha (5) në proces zbatimi në vlerën 1,897 mijë lekë.

B1/2 Dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi: Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese gjatë periudhës së auditimit, u konstatua dëm ekonomik i pa arkëtueshëm në vlerën **6,089 mijë lekë**, për të cilin është lënë 1 rekomandim nga KLSH. Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

B.2. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efizienz dhe efektivitet të fondeve publike nga 4 rekomandime gjithsej në vlerën 3,603 mijë lekë, janë pranuar 2, ndërsa 2 masa në vlerën 1,398 mijë lekë nuk janë pranuar. Nga rekomandimet e pranuar janë në proces zbatimi 2 rekomandime në vlerën 2,205 mijë lekë.

C. Masa me karakter disiplinor. Nga 12 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej janë pranuar të gjitha nga të cilat janë zbatuar plotësisht të 12 rekomandimet.

REKOMANDIMET

Në përfundim rikërkojmë nga Shoqëria "Porti Detar Vlorë" sh.a, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1133/8 prot, datë 24.04.2018, mbi auditimin me objekt mbi "Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare", për periudhën e veprimtarisë 01.04.2015 deri më datën 31.10.2017, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, ka rezultuar se ana e KLSH-së, me shkresën nr. 1073/35, datë 29.01.2016, janë dërguar rekomandimet për masat e pazbatuara nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë dhe gjendja e zbatimit të tyre për katër rekomandime është si më poshtë:

Rekomandimi 1. Këshilli Mbikëqyrës, të marrë në analizë si dhe të evidentojë përgjegjësitë konkrete për efektin financiar negativ në vlerën 2,500,964 lekë, të shkaktuar nga ndërprerja e marrëdhënieve administrative të punës për 23 punonjës të shoqërisë.

Rekomandimi 2. Këshilli Mbikëqyrës, të analizojë dhe të evidentojë përgjegjësitë konkrete për efektin financiar negativ të shkaktuar nga largimet e padrejta nga puna të punonjësve në vlerën **5,359,162 lekë**.

Rekomandimi 3. Këshilli Mbikëqyrës të marrë në analizë si dhe të evidentojë përgjegjësitë konkrete për efektin financiar negativ në vlerën 550,894 leke, të shkaktuar si investim jo ne përputhje me parimet e ekonomikitetit, efizienz dhe efektivitetit, si dhe jashtë objektit të prokurimit "Rehabilitim i murit rrethues dhe godinave të Portit Detar Vlorë.

Rekomandimi 4. Këshilli Mbikëqyrës të marrë në analizë si dhe të evidentojë përgjegjësitë konkrete për shpenzimin e kryer në vlerën 3,817,920 lekë, me objekt "Blerje makineri-pajisje për kabinat elektrike 20kV TIP me bokse të Portit Detar Vlorë", shpenzim jo ne përputhje me parimet e ekonomikitetit, efizienz dhe efektivitetit, për arsye se nuk është argumentuar teknikisht nevoja e kryerjes së kësaj procedure (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim indentifikohet me nr. 17, faqe 266).

Rekomandimi 1: Këshilli mbikëqyrës i shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë, të marrë masa të menjëhershme për shqyrtimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin paraardhës dhe të përcaktojë përgjegjësitë për mangësitë e konstatuara dhe afatet kohore për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi:

Nga verifikimi i dokumentacionit të zbatimit të punimeve në objektin “Krijimi i rrjetit data të institucionit të sigurt dhe të mbrojtur nga sulmet e jashtme, telefonia VOIP dhe sistemi i komunikimit email të institucionit”, rezulton se zbatimi i punimeve duhet të kishte filluar në datën 28.08.2017 dhe të përfundonte në datën 27.11.2017. Me shkresën e protokolluar në Porti Detar sha Vlorë me nr. 879 prot., datë 06.12.2017, ose 8 ditë pas përfundimit të kontratës, është kërkuar nga nënkontraktori “V” SHPK shtyrje e afatit të përfundimit të punimeve për shkak të forcave madhore, (përmbajtje e zyrave) deri në datën 29.12.2017, kërkesë kjo e miratuar nga AK me shkresën nr. 879/2, datë 06.12.2017. Miratimi i kësaj kërkesë është në kundërshtim me kushtet e kontratës, pasi kërkesa për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve është bërë pas afatit kontraktual të përfundimit të punimeve dhe nuk ka patur forcë madhore që të justifikojë afatin e shtyrjes së punimeve me 30 ditë. Nga llogaritjet e bëra për penalitetet, në rast të mos aprovimit të shtyrjes së kontratës, do të kishim $0.004 \times 9,000,000 \text{ lekë} \times 30 \text{ ditë} = 1,080,000 \text{ lekë}$ penalitete (*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 6, faqe 269*).

Rekomandimi 1: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të shqyrtojë vlerën **1,080,000 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me mungesën e penaliteteve për mosdorëzimin në kohë të shërbimit, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “Porti Detar” SHA Vlorë.

B.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se Shoqëria I shpk dhe Porti Detar sha Vlorë, kanë lidhur kontratën me nr. 450 Prot, datë 01.06.2017, për vendosjen e 16 m^2 reklama brenda territorit të Portit Detar Vlorë. Në kushtet e kontratës është vendosur periudha kohore prej 7 muajsh, çmimi $5,000 \text{ lekë/m}^2$ në vit dhe detyrimi i shoqërisë I shpk për pagesën paraprake të qirasë.

Nga përlllogaritja e bërë në zbatim të kontratës së sipërshënuar, rezulton se shoqëria Irish shpk duhet të kryente paraprakisht pagesën prej $16 \text{ m}^2 \times 5,000 \text{ lekë/m}^2$ në vit për 7 muaj = $46,667 \text{ lekë}$. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se në vendimin nr. 18, datë 27.07.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Portit Detar SHA Vlorë, tarifa e reklamës së thjeshtë dhe promocionit është $5,000 \text{ lekë/m}^2$ në muaj dhe nga rilllogaritja tarifa e paguar duhet të ishte $16 \text{ m}^2 \times 5,000 \text{ lekë/m}^2$ në muaj $\times 7 \text{ muaj} = 560,000 \text{ lekë}$. Shoqëria I shpk ka paguar $42,500 \text{ lekë}$, ose **517,500 lekë** më pak se detyrimet sipas tarifave të miratuara, vlerë kjo që është efekt financiar negativ për shoqërinë (*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 2, faqe 272*).

Rekomandimi 1: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të shqyrtojë vlerën **517,500 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me vendosjen e tarifës së reklamave në mospërputhje me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën efekt financiar negativ për Shoqërinë “Porti Detar” SHA Vlorë.

2. Gjetje nga auditimi:

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 04.04.2017, Drejtori i shoqërisë z. A.M, me Urdhrin nr. 113, datë 26.04.2017 “Mbi rritjen e nivelit të pagës bazë të punonjësve të “Porti Detar” Vlorë SHA”, ka vendosur që efektet financiare të rritjes së pagave me fuqi prapavepruese, edhe pse e pa miratuar nga Ministri, të fillojnë nga data 1 Shkurt 2017. Ky urdhër i drejtori të shoqërisë, është nxjerrë në tejkalim të kompetencave të tij ligjore, për

arsye se është në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, si dhe me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 04.04.2017. Nga ky ndryshim me fuqi prapavepruese, ka ndikuar në rritjen e detyrimeve për paga për muajt Shkurt dhe Mars 2017, **në vlerën 880,410 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ** për llogari të shoqërisë (*Në Raportin Përfundimtar të Auditimit ky rekomandim identifikohet me nr. 4, faqe 274*).

Rekomandimi 2: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të shqyrtojë vlerën **880,140 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me rritjen e nivelit të pagave nga Drejtori i shoqërisë me vendim me fuqi prapavepruese, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën efekt financiar negativ për Shoqërinë “Porti Detar” SHA Vlorë.

TË TJERA

-Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të parë të vitit 2019, verifikimi i zbatimit të të cilave do të kryhet në auditimin e radhës që KLSH do kryejë në këtë Institucion.

-Rekomandimet për zbatimin e rekomandimeve të rezultuara të pazbatuar nga auditimi i ushtruar “*Mbi verifikimin e zbatimit të masave të rekomanduara në auditimet e ushtruara në periudhën tetor 2017- prill 2018*”, do të përcillen në subjekte brenda muajit dhjetor 2018.

- Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Financimeve të Huaja. Ky Vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R